

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

TEMË E MAGJISTRATURËS

**VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT ME VËSHTRIM TË
POSAÇËM NË KOSOVË**

MENTORI

Prof. Dr. Ismail Zejneli

KANDIDATI

Admir Ramadani

Tetovë, 2020

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE:	4
HYRJE:	5
Lënda e Hulumtimit	8
Qëllimet e Hulumtimit	9
Hipotezat	9
Metodologjia e Punimit	9
Rëndësia e Punimit	10
KAPITULLI I PARË:	11
Konceptet themelore e të Drejtave të Njeriut dhe Zbatimi i Instrumenteve Ndërkombëtare në Kosovë	11
1.1. Konceptet themelore për të drejtat dhe lirit themelore të njeriut	11
1.2 Mbrojtja e të drejtave të Njeriut në aspektin Ndërkombëtar	13
1.3 Zbatimi i Instrumenteve Ndërkombëtare në Kosovë	15
1.4 Të Drejtat Civile dhe Politike	18
1.5 E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë	20
1.6 E Drejta për Jetë dhe Integritetet Personal	21
1.7 Mos-diskriminimi	22
KAPITULLI I DYTË	24
Korniza Ligjore dhe të Drejtat Themelore të Njeriut në Kosovë	24
2. Korniza ligjore e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kosovë	24
2.1 Liria e Shprehjes	25
2.2 Liria e mendimit, besimit dhe fesë	27
3. Privimi i kundërligjshëm i lirisë	28
4. Tortura	30
5. Cenimi i paprekshmërisë së banesës	33
6. Parandalimi i ushtrimit të drejtës së votimit	35
7. Cenimi i fshehtësisë së votimit	36
8. Mashtrimi në votime	38
Progresi në zgjidhjen e lëndëve nga Gjykatat Komunale për mashtrim në zgjedhje	40

KAPITULLI I TRETË:	42
Mbrojtja e Kategorive të Caktuar të Drejtave të Njeriut në Kosovë	42
9. Të drejtat e fëmijëve	42
9.1 Format e mbrojtjes të fëmijëve	45
9.2 Të drejtat e personave me nevoja të veçanta	47
9.3 Të drejtat e Grave dhe Barazia Gjinore	49
9.4 Të drejtat e punëtorëve dhe sindikatave	52
9.5 Liria e tubimit dhe asociimit	54
9.6 E drejta pronësore	54
9.7 Të drejtat e pakicave	55
KAPITULLI I KATËRT	60
Roli i Organizatave Jo-Qeveritare dhe Mbrojtja Ligjore e të Drejtave të Njeriut në Kosovë	60
10. Roli i Organizatave Jo-qeveritare Ndërkombëtare dhe Vendore	60
10.1 Roli i gjyqësorit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut	63
10.2 E Drejta e respektimit të jetës private dhe familjare	65
10.3 E drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm	66
10.4 Avokati i popullit dhe roli i tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut	68
11. Realizimi i Hulumtimit: Perceptimi Qytetarë për Lirit dhe të Drejtat e Njeriut në Kosovë	69
11.1 Anketa	70
PËRFUNDIMI:	76
LITERATURA:	79

LISTA E SHKURTESAVE:

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OJQ - Organizatat e Shoqërisë Civile

GJND - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

LP - Lufta e Parë Botërore

LD - Lufta e Dytë Botërore

RAI - Ashkali, Rom, Egjiptian

UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

BSPK - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës

GJEDNJ - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës

KNDESK - Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

HYRJE:

Tema e Magjistraturës me titull “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut me vështrim të posaçëm në Kosovë”, është e një rëndësie të veçantë për trajtim si në aspektin shkencor, po ashtu, në atë hulumtues dhe përmbajtjesorë. Kosova edhe pse një shtet i ri, i pa konsoliduar sa duhet dhe me pengesa ndër më të ndryshmet, është duke bërë hapa drejtë vënies së bazave të shëndosha drejtë avancimit të të drejtave të njeriut, edhe pse, një përpjekje e tillë akoma konsiderohet sfiduese. Të drejtat e njeriut në aspektin ndërkombëtarë me theks të veçantë në çështjet e barazisë ndërmjet dy gjinive, nga shumë studiues konsiderohet si imediat dhe mjaft i rëndësishëm për faktin se, respektimi, garantimi dhe avancimi i të drejtave të njeriut do të luaj rolë të madh në stabilitetin vendorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë. Në këtë rrafsh, Kosova ka bërë disa hapa të rëndësishëm si në aspektin e së drejtës duke rregulluar disa nga çështjet kyçe në aspektin ligjor në çështjet e të drejtave të njeriut, duke filluar nga Kushtetuta, Ligjet për të Drejtat e Njeriut, Ligjet ndërlidhëse që garantojnë të drejtave e njeriut, marrëveshjet si dhe aktet e ndryshme ndërkombëtare. Duke u bazuar në parimin e mos diskriminimit gjinor një bashkëpunimi i tillë duhet të jetë në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës si dhe me Konventat Ndërkombëtare. Prandaj, trajtimi i temës në fjale konsiderojë se do ti shërbejë shkencës dhe shkencëtarëve të cilët merren me këtë fushë në mënyrë aktive, institucioneve kosovare dhe atyre rajonale, por, mbi të gjitha do të jetë një hap drejtë avancimit të të drejtave të njeriut. Temën e Magjistraturës e kam ndarë në katër kapituj, në secilin nga ta në mënyrë koherente dhe të argumentuar do ti paraqes të gjeturat dhe të arriturat shkencore.

Kapitulli i parë: Në këtë kapitull, fokusi kyç do të jenë konceptet themelore dhe të përgjithshme e të drejtave të njeriut. Me qenë se, të drejtat e njeriut burojnë nga gjendja natyrore e tij, garantimi i këtyre të drejtave është i domosdoshëm si në aspektin e brendshëm të Shteteve, po ashtu, në atë Ndërkombëtarë. Një elaborim lidhur me të drejtat e njeriut në aspektin Ndërkombëtarë, mbi çka bazohen këto të drejta dhe cilat konsiderohen Aktet e para Ndërkombëtare të cilat avancojnë lirit dhe të drejtat e njeriut. Zbatimi i Konventave Ndërkombëtare sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, konsiderohen si testi i parë i një Shteti demokratik dhe në këtë aspekt, do ti cek Konventat bazë të cilat janë obligim kushtetues në Kosovë. Të drejtat civile dhe politike, duke u bazuar në Konventat

Ndërkombëtare konsiderohen si elemente bazë në respektimin e të drejtave të njeriut. Ndërsa, e drejta për liri dhe siguri, konsiderohet si elementi bazë i të drejtave për çdo njëri, pavarësisht prejardhjes. Mungesa e lirisë dhe sigurisë ka qenë, është dhe si duket do të jetë, shkak kryesor i konflikteve në mes individëve po ashtu në mes popujve dhe shteteve. E drejta për jetë dhe integritet personal, duke u bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe atë vendore konsiderohen si të drejta të cilat lindin me vetë njeriun dhe cenimi apo mohimi i këtyre të drejtave nënkupton, mohimin e së drejtës për të jetuar. Mos diskriminimi në vete ngërthen të gjitha llojet e parandalimit të diskriminimit ndaj njeriut, madje, diskriminimi si fenomen ka qenë dhe akoma vazhdon të jetë, njëra ndër problemet kryesore me të cilën atakohen pothuajse shumica e shoqërive dhe vendeve në botë.

Kapitulli i dytë: Sa i përket Kosovës se sa ka avancuar në ngritjen e infrastrukturës ligjore lidhur me të drejtat e njeriut, do të bëjë një studim të detajuar se ku qëndron Kosova në këtë aspekt. Sa i përket kornizës ligjore të Kosovës një rolë të rëndësishëm pozitiv e kanë pasur dhe akoma vazhdojnë të kenë faktori ndërkombëtarë si dhe Organizatat Ndërkombëtare dhe Vendore në përmbushjen e zbrastësirave ligjore sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut. Do të trajtojë në mënyrë të detajuar dhe të argumentuar të gjitha komponentët të cilat konsiderohen si të domosdoshme në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave themelore të njeriut siç janë: e drejta e shprehjes, liria e mendimit, besimit dhe fesë, privimi i kundërligjshëm i lirisë, tortura, cenimi i paprekshmërisë së banesës, parandalimi i ushtrimit të drejtës së votimit, cenimi i fshehtësisë së votimit, mashtrimi në votime si elemente bazë të të drejtave të njeriut.

Kapitulli i tretë: Fokusi do të jetë të disa kategori të caktuara të njeriut në Kosovë të cilat konsiderohen si më të atakuar, prandaj, mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të këtyre kategorive është konsideruar si një ndër sfidat kryesore për Kosovën. Sa i përket fëmijëve dhe të drejtave të tyre, Kosova edhe pse kohëve të fundit ka bërë disa përparime në aspektin ligjor, akoma konsiderohet larg arritjes së standardeve bashkëkohore në lirit dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Do të cekë format kryesore të mbrojtjes së fëmijëve, kategoritë e fëmijëve të cilët janë më të atakuar si dhe mundësit dhe kapacitetet institucionale dhe shoqërore lidhur me këtë kategori. Si sfidë e veçantë për Institucionet e Kosovës si dhe shoqërinë në përgjithësi, konsiderohen të jenë njerëzit me nevoja të veçanta të të gjitha kategorive, kur kihet parasysh

se Kosova e dalë nga Konflikti, mungesa e kapaciteteve të specializuara njerëzore, mungesa e mjeteve financiare, shumë nga këto kategori akoma vazhdojnë të përballën me veshtësit në realizimin e të drejtave të tyre elementare. Të drejtat e Grave dhe Barazia Gjinore në Kosovë, krahasuar me kategoritë e tjera, të paktën në aspektin ligjorë konsiderohen më të avancuara, po ashtu, një rolë të madh në avancimin në praktikë e kanë dhënë dhe akoma vazhdojnë të japin Organizatat Jo-Qeveritar vendore dhe ndërkombëtare. Kurse, sa i përket të drejtave të punëtorëve dhe sindikatave kryesisht në sektorin privat, Kosova sa i përket aspekti ligjor konsiderohet se ka bërë adoptimin e duhur ligjor në përputhje me standardet evropianë, problemi akoma vazhdon të jetë mos respektimi i të drejtave të punëtorëve në sektorin privat. Rolë destruktivë pa dyshim kanë luajtur të gjitha Qeveritë e vendit, duke bërë një diskrepancë të madhe për sa i përket realizimit të këtyre të drejtave në mes sektorit publike dhe atij privat. Në sektorin publik, pothuajse në të gjitha nivelet është bërë një përparim i madh sa i përket respektimit dhe të ardhurave materiale mujore, ndërsa, sa i përket sektorit privat, punëtorët akoma në shumicën e rasteve nuk i gëzojnë as të drejtat elementare të njeriut. Një element shumë i rëndësishëm dhe domethënës për shoqëritë demokratike dhe në këtë rast për Kosovën, konsiderohet respektimi i tubimit dhe asociimit për realizimin e të drejtave të grupeve të interesit. Sa i përket kësaj të drejte në parim konsiderohet se ka një avancim të dukshëm kur kihet parasysh të drejtat legjitime të cilat i kanë secili qytetarë më konventa dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë. Sa i përket të drejtës pronësore si e drejtë elementare e çdo njeriu, Kosova edhe në këtë aspekt ka avancuar në aspektin ligjorë, mirëpo, sfida kyçe vazhdon të jetë realizimi i kësaj të drejte në praktik për të cilën akoma vazhdojnë të ekzistojnë veshtësit sidomos në ndërrimin e perceptimit qytetar se çdo njëri pavarësisht gjinisë së tij duhet të gëzojë të drejtat e tij pronësore. Të drejtat e pakicave në Kosovë si në aspektin ligjor po ashtu edhe në atë praktik, konsiderohen të jenë të avancuar për sa i përket të drejtave të njeriut, madje, të drejtat e komunitetit serbë në Kosovë konsiderohen të drejtat më të avancuara që mund ti ketë ndonjë komunitet diku në botë, dhe kjo duke u bazuar në Planin e Ahtissarit ka bërë që edhe dallimi në mes të drejtave të komuniteteve të jetë i madh në mes atij serb dhe komuniteteve tjera. Komuniteti RAI (Ashkali, Rom dhe Egjiptian) akoma konsiderohen si më të

diskriminuar në shoqëri për sa i përket çështjes së arsimit, punësimit dhe integritit në shoqërinë kosovare.

Kapitulli i katërt: Fokusi i trajtimit do të jetë roli i Organizatave Jo-qeveritare ndërkombëtare dhe vendore në mbrojtjen dhe të drejtat e njeriut. Kontributi i Organizatave Jo-qeveritare konsiderohet mjaft domethënës në avancimin dhe avokimin për të drejtat e njeriut. Njëra ndër të drejta bazë të cilat konsiderohen të mbrojtura dhe të pa prekura konsiderohet e drejta e privatësisë dhe asaj familjare. Në çështjen e së drejtës si element bazë në Kosovë konsiderohet si e avancuar por që lë shumë për të dëshiruar, prandaj, trajtimi i kësaj të drejte nënkupton trajtimin e elementit bazë të një të drejtë të njeriut. Realizimi i të drejtave të njeriut padyshim se mbështet në të drejtën ligjore si dhe mekanizmat ligjor të cilët janë të obliguar që këto të drejta ti vënë në praktik. Një rolë të tillë kyç dhe pothuajse më kryesorin e ka gjyqësori, prandaj, në aspektin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut do të trajtojë rolin e gjyqësorit në Kosovë në realizimin e këtyre të drejtave. Krejt në fund do të trajtojë rolin e Avokatit të popullit në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Edhe pse, në shumë raste, roli i Avokatit të Popullit ka qenë shumë pozitiv në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Realizimi i Hulumtimit: Perceptimi Qytetarë për Lirit dhe të Drejtat e Njeriut në Kosovë. Në kuadër të Punimi të Magjistraturës do të bëjë një Hulumtim më Qytetarët e Kosovës lidhur më Perceptimin Qytetarë për lirit dhe të drejtat e njeriut në Kosovë. Sa kanë njohuri për të drejtat themelore të tyre? Sa respektohen të drejtat e njeriut në Kosovë? Cila kategori e njerëzve konsiderohet më e marginalizuar në Kosovë? Sa respektohen të drejtat e fëmijëve në Kosovë? Sa respektohen të drejtat e grave? Ky Hulumtim do të jetë një barometër matës lidhur me atë se sa në praktik njihen dhe mbrohen të drejtat dhe lirit e njeriut në Kosove.

Lënda e Hulumtimit

Lënda bazë e hulumtimit të temës së magjistraturës do të jetë ajo e trajtimit të të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë, të drejtat e njeriut në Kosovës. Hulumtimi do të bëhet në mënyrë kronologjike duke trajtuar pikat kyçe të respektimit, mbrojtjen dhe avancimin e tyre, rolin që ka më pas në sferën e brendshme po ashtu edhe në atë rajonale dhe ndërkombëtare. Lënda e

studimit në çështjen e të drejtave të njeriut përfshin nocionin, karakteristikat themelore si dhe formën e garantimit, respektimit dhe mbrojtjes e tyre në aspektin njerëzor dhe ligjor.

Qëllimet e Hulumtimit

Qëllimi i temës së magjistraturës me titull “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut me vështrim të posaçëm në Kosovë” konsiston me të drejtat themelore të njeriut të cilat janë të garantuara me Konventa Ndërkombëtare, Kushtetutën, Ligjet si dhe aktet Nënligjore. Prandaj, qëllimi kyç i temës në fjalë është hulumtimi shkencor kualitativ dhe kuantitativ, mënyra e rregullimit dhe mbrojtjes sipas akteve dhe normave ligjore vendore dhe ndërkombëtare. Qëllimi i saj bazohet në të drejtat bazë të çdo njeriu, rëndësinë që kanë këto të drejta si dhe rolin dhe sfidat që i ka Kosova drejtë realizimit të një të drejte të tillë të garantuara me Konventa dhe akte ndërkombëtare.

Hipotezat

Gjatë realizimit të punës time shkencore dhe hulumtuese mund të përballem edhe me çështje apo pyetje hipotetike të cilat edhe kërkojnë përgjigjeje adekuate dhe akademike. Pyetjet kërkimore apo hipotezat e ngritura veç sa do ta begatojnë edhe më shumë hulumtimin tim shkencorë. Si pyetje kërkimore – hipoteza që përkojnë me temën në fjalë janë:

1. Sa vihen në praktik zbatimimi i Instrumenteve Ndërkombëtare sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kosovë?
2. Sa respektohen të drejtat dhe lirit themelore të Njeriut në Kosovë?
3. Sa respektohen të drejtat dhe lirit themelore të komuniteteve jo shumicë në Kosovë?

Metodologjia e Punimit

Metodologjia shkencore është shumë e rëndësishme në punën shkencore dhe si e tillë konsiderohet njëra ndër elementet bazë dhe kyçe në përcaktimin dhe definimin e mënyrës së hulumtimit dhe arritjes së punës shkencore. Gjatë hulumtimit dhe punës time në Temën e Magjistraturës do të përpiqem të përdor metoda dhe teknika të cilat janë në përputhje të plotë me metodologjitë moderne dhe bashkëkohore të kërkimit shkencor. Do të përdorë metodën historike, krahasuese, analitike, hulumtuese, sintetike dhe cilësore, të cilat do të më ndihmojnë

për trajtim kronologjik të zhvillimit të temës. Ekzistojnë burime të shumta dhe të rëndësishme si vendore po ashtu edhe ndërkombëtare që trajtojnë çështjen në fjalë. Do të hulumtojmë lëndën, dokumente e materiale relevante lidhur me qëllimin bazë të temës.

Rëndësia e Punimit

Mbrojtja, respektimi dhe avancimi i lirive dhe të drejtave të njeriut është shumë i rëndësishëm për çdo shtet dhe shoqëri. Kjo për faktin se, përmes bashkëpunimit Institucion-Qytetarë arrihet të luftohet si dhe të parandalohet diskriminimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut, ndëshkimi e autorëve të cilët mund ta shfrytëzojnë pozitën e tyre për të mos u dënuar për veprën e bërë. Prandaj, rëndësia e respektimit dhe garantimit të të drejtave të njeriut konsiston jo vetëm në rregullimin e brendshëm ligjor të një shtetit, por, edhe atë të shkëmbimit të përvojave si dhe ngritjen e efikasitetit në ruajtjen e sigurisë njerëzore në aspektin e brendshëm, rajonale dhe ndërkombëtare.

KAPITULLI I PARË:

Konceptet themelore e të Drejtave të Njeriut dhe Zbatimi i Instrumenteve Ndërkombëtare në Kosovë

1.1. Konceptet themelore për të drejtat dhe lirit themelore të njeriut

“Populli i lirë dëgjon por nuk shërben, ai ka prijës por nuk ka zotëri, ai dëgjon vetëm ligjet, falë ligjeve, ai nuk u nënshtrohet njerëzve”.

ROUSEAU

Të drejtat dhe lirit themelore të njeriut para se gjithash konsiderohen si të drejta natyrore dhe si i tillë, “koncepti i të drejtave të njeriut bazën e vetë shprehimore e gjen në teorinë natyrore-juridike”¹. Ideja mbizotëruese i konsideron të drejtat e njeriut si të drejta që individi i gëzon nga vetë qenia e njeriut, pavarësisht nga raca, feja, kombësia, gjinia, mosha, preferenca politike, pozita pasurore². Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, potencon qartë se kur këto të drejta konsiderohen të garantuara, të mbrojtura dhe të pacenueshme. Deklarata në Nenin 1 thotë, “të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të drejtave. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit në një frymë vëllazërore”³.

Njeriu dhe pozita e tij në shoqëri gjatë historisë së njerëzimit ka qenë dhe si duket do të jetë çështje preokupuese, komplekse, shoqërore dhe shkencore. Me ndryshimin e raporteve shoqërore, ekonomike, politike, juridike, kulturore dhe raporteve të tjera, ndërron edhe pozita shoqërore dhe juridike e njeriut në shoqëri. Mbrojtja e vlerave siç janë: jeta e njeriut, integriteti fizik, liritë dhe të drejtat, siguria e tij, të mirat materiale dhe vlerat e tjera janë kusht themelore për pozitën e njeriut dhe për zhvillimin e përgjithshëm shoqëror⁴.

¹ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 30.

² “Njohja dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut është themel i shoqërisë demokratike, sikurse paqja që është parakushti i domosdoshëm për mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut në shtete të veçanta dhe në komunitetin ndërkombëtarë”. Shih, Arben Puto, Sfidat e të Drejtave të Njeriut për një Shoqëri të lirë, Tiranë, 2015, fq. 14.

³ DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948, Neni 1.

⁴ Ali Bajgora, Revista “E Drejta”, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Viktimizimi i Fëmijëve dhe të miturve në Kosovë në periudhën 1981-1995, Prishtinë, 1996, fq. 191.

Të drejtat dhe lirit themelore të njeriut trajtoheshin si të drejta të përcaktuara me ligj natyror ose ligj të Perëndisë. Këto të drejta, me qenë se ishin të dhëna nga Perëndia, njeriu duhet t'i gëzoj që nga lindja e tij dhe konsiderohen të paprekshme dhe të patjetërsueshme⁵. Në një version tjetër, të drejtat e njeriut mund të konceptohen si norma të përgjithshme morale, që burojnë nga natyra njerëzore dhe mund të definoohen si të drejta që janë të qenësishme për natyrën tonë dhe pa të cilat ne nuk mund të jetojmë. Garantimi i të drejtave të njeriut në praktik na mundëson të shfrytëzojmë dhe zhvillojmë inteligjencën tonë, shkathtësitë, talentin, vetëdijen dhe në këtë mënyrë mund t'i plotësojmë nevojat tona fizike dhe shpirtërore⁶. “Të drejtat dhe liritë e njeriut janë mburojë që na mbulon dinjitetin njerëzor nga cenimet. Këto të drejta nuk na japin garanci që të tjerët do të na duan apo do të kujdesen për ne, as nuk na garantojnë lumturin e jetës, as drejtësi, as mirëqenie minimale, këto të drejta vetëm na mbrojnë nga poshtërim dhe nga cenimet në dinjitetin tonë”⁷.

Të drejtat e njeriut para se të trajtoheshin në aspektin universal, fillimisht trajtoheshin si kompetencë apo e drejtë e brendshme e shteteve, të cilat i rregullonin me deklaratat, ligje ose kushtetutë. Të drejtat e njeriut fillojnë të marrin karakter universal vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, ngase vetëm njohja dhe mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut mund të garantojë të drejtat e njeriut dhe të mos përsëriten krimet dhe dhuna që kishte ndodhur në shumë vende të Botës, duke shkakuar viktima të shumta të njerëzve në Luftën e Parë dhe në Luftën e Dytë Botërore. “Për këtë arsye, pas Luftës së Dytë Botërore u fillua me hulumtimin e përparimit të konceptit parësor të shtetit të së drejtës, ndërsa të drejtat e njeriut pushuan së qeni shprehje e “sovrانيتit” të shtetit të së drejtës, duke fituar karakter universal”⁸. Duke u nisur nga ky parim, Presidenti Amerikan Franklin D. Roosevelt në mesazhin e tij vjetor drejtuar Kongresit më 6 janar 1941, kërkojë respektimin e katër lirive themelore të njeriut; liria e fjalës dhe të shprehurit; liria e besimit; liria nga mjerimi dhe liria nga frika⁹. “Të çmuarit e vlerës unike të çdo qenieje njerëzore nga ana e bashkësisë ndërkombëtare çoi jo vetëm kah përpjekjet

⁵ Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Prishtinë, 2010, fq. 4, 5.

⁶ KRIJIMI I KOMUNËS MIKE PËR FËMIJË, GJAKOVA KOMUNË MIKE PËR FËMIJËT, Gjakovë, 2017, fq. 7.

⁷ Alekt Hyseni, Të Drejtat e Njeriut në Kushtetutën Shqiptare, Tiranë, 2010, fq. 14.

⁸ Dr. Dejan Millenković, Të drejtat e njeriut, liria e shprehjes, të drejtat e pakicave dhe roli i medimeve në kushtet e konfliktit dhe tensionit, Doracak për punën e medieve lokale, NISH, 2010, fq. 12.

⁹ Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Prishtinë, 2010, fq. 11.

për eliminimin e elementeve destruktive për individin, por edhe për krijimin e kushteve të cilat do t'i mundësonin atij ose asaj që të zhvillohet dhe përparojë”¹⁰.

Duke u bazuar në këto parime, padyshim të gjithë njerëzit pa dallim duhet të pajisen me dinjitetin njerëzor dhe me të drejtën për të jetuar në liri dhe për t'i gëzuar të drejtat dhe lirit e tyre. Në sistemet demokratike, shteti duhet t'i shërbejë njeriut dhe njeriu duhet t'i shërbejë shtetit. “Lirit dhe të drejtat themelore i japin çdo njeriu të drejtën për të zhvilluar lirisht personalitetin e tij, duke përfshirë këtu edhe zgjedhjen për gjërat kryesore të jetës. Kjo kërkon nga njeriu të bëjë zgjedhje të rëndësishme, të cilat ndikojnë tek njëra-tjetra në mënyrë të ndërsjellë dhe koncepti i identitetit lidhet ngushtë me diversitetin, lirinë, barazinë dhe përgjegjësinë individuale dhe shoqërore”¹¹. “Këto të drejta janë të patjetërsueshme, ato nuk mund ti merren asnjë personi. Për më tepër, të drejtat e njeriut mbrohen nga e drejta ndërkombëtare dhe të drejtat e brendshme të shteteve”¹².

1.2 Mbrojtja e të drejtave të Njeriut në aspektin Ndërkombëtar

Të drejtat e njeriut janë shtylla e paqes botërore, stabiliteti ndërkombëtarë buron nga respektimi, mbrojtja dhe përparimi i të drejtave të njeriut. Prandaj, të gjitha dokumentet ndërkombëtare, por edhe rendet juridike nacionale, mbështeten në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, të miratuara nga organizatat supranacionale¹³. Të drejtat dhe lirit themelore të njeriut janë trajtuar që nga kohërat e vjetra në forma dhe aspekte të ndryshme. Por, si dokumente të para dhe më vlerë historike mund të dallohen: Karta e Madhe e Lirive (Magna Carta Libertatum) e vitit (1215); Ligji për të Drejtat (Bill of Rights) e vitit (1689);

¹⁰ Marek Piechowiak, ÇKA JANË TË DREJTAT E NJERIUT? KONCEPTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE ARSYETIMI EKSTRA JURIDIK I TYRE, Prishtinë, 2001, fq. 4.

https://www.researchgate.net/profile/Marek_Piechoëiak/publication/248604029_Cka_jane_te_drejtat_e_njeriut_Koncepti_i_te_drejtave_te_njeriut_dhe_arsyetimi_ekstra_juridik_i_tyre/links/00b7d51e0116d51c22000000/Cka-jane-te-drejtat-e-njeriut-Koncepti-i-te-drejtave-te-njeriut-dhe-arsyetimi-ekstra-juridik-i-tyre.pdf
Vizituar më: 10.02.2020.

¹¹ Konceptet themelore në EQD/EDNJ, <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-1/part-1/unit-3/chapter-6/>, Vizituar më: 14.01.2020.

¹² Komisari i Lartë për të Drejtat e Njeriut, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë, Të drejtat e Njeriut dhe Zbatimi i Ligjit, Doracak për Trajnim të Policisë mbi të Drejtat e Njeriut, Kombet e Bashkuara, Nju Jork dhe Gjenevë, 1997, fq. 36.

¹³ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 97.

Deklarata e Pavarësisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e vitit (1776); Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit e vitit (1789)¹⁴.

Karta e Madhe e Lirive (Magna Carta Libertatum) e vitit (1215), parashihte se askush nuk mund të privohet nga liria dhe pasuria e tij jashtë ligjit ose të dëbohet pos në bazë të ligjit. Ligji për të Drejtat (Bill of Rights) e vitit (1689), përmban rregulla të cilat e kufizojnë dukshëm pushtetin absolutist dhe garantojnë një mbrojtje më të madhe të drejtave të njeriut¹⁵. “Këtu është fjala për një liri të dhuruar me vullnet, e cila është shtrënguar t’i shërbejë e nënshtrohet këtij vullneti”¹⁶. Deklarata e Pavarësisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (1776) thotë se, “të gjithë njerëzit janë të krijuar të barabartë; Krijuesi u ka dhënë disa të drejta të patjetërsueshme; Qeveritë janë krijuar për ti siguruar këto të drejta dhe autorizimet i nxjerrin nga pajtimi i njerëzve mbi të cilët ushtrojnë pushtetin”. Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit (1789), sipas Nenit 1, “njerëzit lindin dhe rrojnë të lirë dhe të barabartë në të drejta. Dallimet Shoqërore mund të jenë të bazuara vetëm në interes të përbashkët”¹⁷.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut në aspektin ndërkombëtarë bazohet në burimet bazë të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht në burimet ndërkombëtare të përcaktuara në Nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Sipas Nenit 38 të Statutit të GJND-së, “gjykata, misioni i së cilës është që të rregulloj sipas të drejtës ndërkombëtare grindjet që i parashtrihen, zbaton: a) konventat ndërkombëtare, qofshin të përgjithshme ose të posaçme që përmbajnë rregulla shprehimisht të njohura nga Shtetet në grindje; b) zakonet ndërkombëtare si provë të një praktike të përgjithshme të pranuar si ligj; c) parimet e përgjithshme të së drejtës të njohura prej vendeve të qytetëruara; ç) nën rezervën e dispozitës së nenit 59¹⁸, vendimet gjyqësore dhe doktrinën e publicistëve me të cilësuar të vendeve të ndryshme si mjet ndihmës për të caktuar rregullat e së drejtës. Kjo dispozitë nuk cenon të drejtën që ka Gjykata në qoftë

¹⁴ Jordan Daci, Të Drejtat e Njeriut, Botimi i tretë, Tiranë, 2011, fq. 7.

¹⁵ Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Prishtinë, 2010, fq. 7, 8.

¹⁶ Ejup Statovci, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Të Drejtat, Liritë e Njeriut dhe Skllavërimi, Prishtinë, 2009, fq. 93.

¹⁷ Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Prishtinë, 2010, fq. 8, 9.

¹⁸ Vendimet e Gjykatës nuk janë të detyrueshme përveçse për palët ndërgjyqësore në lidhje me rastin për të cilin është marrë vendimi. Shih, Nenin 59 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

se palët e pranojnë që të vendoset ex aequo et bono”¹⁹. “Traktatet ndërkombëtare të njohura nën emërtime të ndryshme, si pakte, konventa apo protokolle, janë juridikisht të detyrueshme për shtetet që i kanë ratifikuar apo aderuar në to”²⁰. Karta e OKB-së në Nenin 1, Paragrafi 3, thekson si të domosdoshme “promovimin, nxitjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë, pa dallim race, seksi, gjuhe apo besimi fetar”²¹.

Të drejtat e njeriut njihen si Universale, që nënkupton se këto të drejta i takojnë të gjitha qenieve njerëzore, pavarësisht prejardhjes si, kombësia, vendi i banimit, gjinisë, prejardhjes kombëtare ose etnike, ngjyrës, fesë, gjuhës apo ndonjë statusi tjetër. Këto të drejta konsiderohen të patjetërsueshme, ngase nuk mund t’i jepet ose merret dikujt (përveç nëse e parasheh ligji). Po ashtu, të drejta e njeriut konsiderohen të pandashme-natyrshme për faktin se, të gjitha të drejtat kanë vlerë dhe rëndësi të barabartë. Parimi i varësisë, që nënkupton se të drejtat e njeriut nuk mund të realizohen të izoluar nga njëra tjetra. Përparimi i një të drejte lehtëson realizimin e tjetrës, ndërsa, privimi i një të drejte ndikon negativisht në të drejtën tjetër²².

1.3 Zbatimi i Instrumenteve Ndërkombëtare në Kosovë

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, tetë instrumentet dhe marrëveshje ndërkombëtare janë të zbatueshme në rendin juridik të Kosovës²³. Përkatësisht në Nenin 22 Kushtetuta obligon aplikueshmëri të drejtpërdrejtë dhe të plotë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në rast të konfliktit, garanton prioritet të tyre në krahasim me ligjet dhe aktet tjera të institucioneve publike. Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare janë: “Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe

¹⁹ Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Neni 38.

²⁰ Qendra për të Drejtat e Njeriut Gjenevë, Të Drejtat e Njeriut, Përmbledhje e Instrumenteve Ndërkombëtare, Kombet e Bashkuara New York dhe Gjenevë, 1994, fq. 2.

²¹ Karta e Kombeve të Bashkuara, Nënshkruar më datë 26 qershor 1945 në San Francisko, hyrë në fuqi më datë 24 tetor 1945, Neni 1, Paragrafi 3.

²² Jordan Daci, Të Drejtat e Njeriut, Botimi i tretë, Tiranë, 2011, fq. 43.

²³ “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës”. Shih, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare, 15 qershor 2008, Neni, 19,.

Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”²⁴.

Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës kryesisht përfshin instrumentet ndërkombëtare me fokus në të drejtat civile, politike dhe të drejtat e minoriteteve, kurse jashtë fushëveprimit e lenë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK)²⁵. Po ashtu Neni 52 i Kushtetutës “i obligon autoritetet e Kosovës interpretimin e dispozitave që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe me liritë në konsekuencë me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Marrëveshja ndërkombëtare e OBK-së mbi të cilat të drejtat civile dhe politike është e përfshirë në Kushtetutë dhe rrjedhimisht, është direkt e aplikueshme”²⁶. Në rast konflikti, detyrimet dhe obligimet që rrjedhin nga këto instrumente dhe marrëveshje ndërkombëtare, janë superiore ndaj detyrimeve që rrjedhin prej ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe akteve tjera të miratuara nga institucionet publike të Republikës së Kosovës²⁷. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Nenin 53 përcakton, “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”²⁸.

Në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut potencohet qartë rëndësia që ka respektimi dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të Njeriut. Në Preambulën e saj ju bënë thirrje të gjithë popujve dhe kombeve që të ndihmojnë respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut me anë të masave progresive kombëtare dhe ndërkombëtare. Deklarata shpreh “se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë dhe secili njeri i gëzon të drejtat dhe liritë themelore pa kurrfarë

²⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, 15 qershor 2008, Neni, 22,.

²⁵ Kushtrim Istrefi, Revista “E Drejta”, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Nr. 1/2013, Prishtinë, Përvetësimi Kushtetues i të Drejtave Ndërkombëtare të Njeriut në Rendin Juridik të Kosovës, fq. 237.

²⁶ Task Forca për Integrim Evropian, DOKUMENT DISKUTIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJEN E MINORITETEVE, fq. 5. http://www.mei-ks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Te_Drejtat_e_Njeriut.pdf Vizituar më: 10.02.2020.

²⁷ Prof. Dr. Qerim Qerimi / Prof. Dr. Remzije Istrefi / Mr. Sc. Flakron Sylejmani, PËRMBLEDHJE E MARRËVESHJEVE DHE INSTRUMENTEVE LIGJORE NDËRKOMBËTARE, Prishtinë, 2016, fq. IX.

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut, 15 qershor 2008, Neni, 53.

kufizimesh pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes. Nuk do të bëhet kurrfarë dallimi pavarësisht statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit”²⁹. Deklarata ndër të drejtat themelore bazë të njeriut ka përmendur të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Po ashtu parashikohen “e drejta për jetë, liri dhe sigurinë e njeriut, e drejta për të mos u trajtuar çnjerëzisht, trajtimi i barabartë, e drejta e lëvizjes së lirë, e drejta e kërkimit të azilit, e drejta e pronësisë, e drejta e shtetësisë, e drejta e besimit, e drejta në qeverisje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përfaqësuese”³⁰.

Të drejtat e parashikuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollat janë: “e drejta për jetë, ndalimi i torturës dhe trajtimi çnjerëzor, e drejta për liri dhe siguri, liria e lëvizjes dhe zgjedhja e vendbanimit, barazia para ligjit, e drejta për privatësi dhe jetë familjare, shtëpi dhe korrespondencë, liria e shprehjes, e drejta e organizimit dhe e drejta e anëtarësimit”³¹. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor ka për synim të detyrojë shtetet palë të dënojnë diskriminimin racial me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë dhe të ndihmojnë mirëkuptimin midis të gjitha racave. Sipas Konventës “diskriminimi racial nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrojë ose të kompromentojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike”³².

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas kërkon nga shtetet palë të marrin të gjitha masat e përshtatshme në të gjitha fushat, “sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjislacionin, me qëllim që t’u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut mbi

²⁹Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor 1948, Neni 1, 2.

³⁰ Kathleen Imholz dhe Elsa Toska (Dobjani), TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT, MANUAL PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE, Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri, Qershor, 2016, fq. 39.

³¹Po aty, fq. 39.

³²Po aty, fq. 40.

bazën e barazisë me burrat. Konventa e përkufizon “diskriminimin ndaj grave” si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, te të drejtave të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër”³³. Shtetet anëtare të Konventës për të Drejtat e Fëmijës duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmijët të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit. Konventa ka edhe tre protokolle opsionale. Protokoli “Mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura” (2000) 55; Protokoli “Për mbrojtjen e shitjes së fëmijëve, prostituimit dhe pornografinë me fëmijë” (2000); Protokoli “Mbi procedurat e komunikimit” (2011)³⁴.

1.4 Të Drejtat Civile dhe Politike

Të drejtat civile dhe politike kërkojnë sigurimin e njeriut, i cili buron nga shteti i së drejtës dhe demokratik, në të cilin ekziston ndarja e pushtetit, dhe e cila legalitetin e bazon në dëshirën e popullit si bartës i sovranitetit shtetëror³⁵. “Termi të drejtat civile e ka prejardhjen nga e drejta romake, në shtetin skllavopronar Romak i nënkuptonte vetëm ato të drejta private që ishin të parapara sipas “ius civile”, dhe mund ti gëzonin (ushtronin) vetëm qytetarët romak me të drejta të barabarta (cives optimo iure)”³⁶.

Duke u bazuar në Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në grupin e të drejtave civile dhe politike bëjnë pjesë, e drejta për jetë dhe siguri personale (Neni 3), liria nga skllavëria dhe nënshtrimi (Neni 4), liria nga nënshtrimi dhe mundimi ose dënimi jonjerëzor dhe poshtëruar (Neni 5), liria nga paraburgimi ose burgimi arbitrar (Neni 9), e drejta për gjykim të drejtë dhe të pavarur (Neni 10), e drejta të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia (Neni 11), e drejta e mos ndërhyrjes në mënyrë arbitrare në jetën private dhe familjare (Neni 12), liria e banimit dhe qarkullimit (Neni 13), e drejta e azilit (Neni 14), e drejta për shtetësi (Neni 15), e drejta e martesës dhe krijimin e familjes (Neni 16), e drejta e pronës (Neni

³³Po aty, fq. 41.

³⁴Po aty, fq. 41.

³⁵ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 61.

³⁶ Asllan Bilalli, Revista “E Drejta”, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Nr. 1-4 / 2017, Prishtinë, ZHVILLIMI HISTORIK I TË DREJTAVE PRIVATE (CIVILE) TË HUAJVE DHE KRITERET PËR KATEGORIZIM LIDHUR ME GËZIMIN NGA TË HUAJT, fq. 59.

17), liria e mendimit, bindjes dhe besimit (Neni 18), liria e shprehjes së mendimit (Neni 19), e drejta e mbajtjes së tubimeve paqësore (Neni 20), e drejta e votës dhe e drejta për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur (Neni 21)³⁷. “Sipas kategorive të drejtat civile të huajve ndahen në: të drejta sendore, familjare, trashëgimore, të drejta detyrimore, përfshirë edhe të drejtën e pronësisë intelektuale, të drejtën e pronësisë industriale dhe të drejtën e autorit”³⁸.

Sipas Raportit të Shtetit Amerikan mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2015 në Kosovë, ndër shqetësimet rreth mos realizimit në mënyrën e duhur të lirive dhe të drejtave të njeriut përfshinin, “keqtrajtimin e raportuar të të ndaluarve nga policia, kushtet fizike nën standarde në burgje; abuzimin me lëndë narkotike, korrupsionin dhe favorizimin në burgje; paraburgimin e gjatë dhe jo efikasitetin e gjyqësorit që përfundon në përmbyllje të rasteve pa gjykim; si dhe kërkesat e pazgjdhura për rikthim të pronës prej luftës së viteve 1998-1999”³⁹. Garantimi i të drejtave civile dhe politike, konsiderohet si sfera më e ndjeshme që paraqet tersin e të drejtave dhe lirive të njeriut në raport me funksionet e organeve shtetërore. “Duke pasur parasysh se marrëdhëniet e individit me pushtetin janë inferiore, ndërsa fuqia e pushtetit shtetërore më e madhe, këto liri dhe të drejta kanë për qëllim të garantojnë se çdo ndërhyrje e organeve shtetërore në këto të drejta duhet të jetë e bazuar në ligj dhe që nuk bie ndesh me standardet ndërkombëtare”⁴⁰.

Të drejtat civile dhe politike edhe pse janë ta garantuara me Konventa Ndërkombëtare, Kushtetut dhe Ligje, fatkeqësisht realizimi i tyre në praktik ka hasur në barriera të ndryshme. Sa i përket mohimit në realizimin e këtyre të drejtave të cilat i përmend edhe Raporti i Shtetit Amerikan si dhe Raportet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, janë vetëm disa më kryesoret. Ky fakt është shqetësues kur kihet parasysh perspektiva e integritimeve Evropiane dhe Euro-atlantike. Këto argumente jo rrallë janë përdorur edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare, e

³⁷ Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor 1948, Neni 3, 4, 5, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21.

³⁸ Asllan Bilalli, Revista “E Drejta”, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Nr. 1-4 / 2017, Prishtinë, ZHVILLIMI HISTORIK I TË DREJTAVE PRIVATE (CIVILE) TË HUAJVE DHE KRITERET PËR KATEGORIZIM LIDHUR ME GËZIMIN NGA TË HUAJT, fq. 59.

³⁹ Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2015, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, RAPORTI I VITIT 2015 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË. https://photos.state.gov/libraries/kosovo/312585/2016/HRreport2015_alb.pdf, Vizituar më: 10. 02. 2020.

⁴⁰ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 65.

sidomos përfaqësuesit e BE-së kur është në pyetje Liberalizimi i vizave dhe perspektiva Evropiane e Kosovës. Një rolë të rëndësishëm në avancimin e këtyre të drejtave pa dyshim e kanë dhënë edhe Organizatat e Shoqërisë Civile Vendore dhe Ndërkombëtare, madje, Raportet e tyre shumë herë merren si referenc primare nga Institucionet Evropiane lidhur me Raportin e Progresit për Kosovën.

1.5 E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë

Çdo njeri pavarësisht prejardhjes së tij gëzon të drejtën për liri dhe siguri personale. Asnjë njeri nuk mund të privohet nga e drejta elementare për liri dhe siguri, përveç kur kjo është si pasojë e shqiptimit të dënimit ligjor me burgim apo urdhrit të dhënë nga ndonjë gjykatë apo tribunal kompetent, i cili është në përputhje të plotë me rendin ligjor vendor dhe ndërkombëtar. Një dënim i tillë apo urdhër mund ti nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor⁴¹. “Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj”⁴².

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës çdo njeri i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Madje, askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, “pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale; për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj; për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm, për mbikëqyrje shëndetësore të personit i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë, për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim”⁴³.

⁴¹ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 124.

⁴² Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 5.

⁴³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë, 15 qershor 2008, Neni, 29,.

1.6 E Drejta për Jetë dhe Integritetet Personal

Çdo “njeri ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake”⁴⁴. E drejta e njeriut për të jetuar, është e drejtë themelore dhe më e rëndësishmja nga të drejtat e njeriut, ngase jeta paraqet vlerën më të shtrenjtë për njeriun dhe të mirën më të lartë të shoqërisë. Njëkohësisht, mbrojtja e integritetit personal, respektivisht mbrojtja nga tortura, trajtimi ose dënimi çnjerëzor apo poshtërues është thelbësor për zbatimin e standardeve të drejtave të njeriut. Së bashku me të drejtën për të jetuar, formon elementet thelbësore për garantimin e dinjitetit njerëzor⁴⁵. E drejta për jetë garantohet dhe mbrohet me Konventat Ndërkombëtare, Kushtetutë, Ligj dhe askush nuk mund të privohet nga e drejta për jetë në mënyrë arbitrare⁴⁶. “Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën e tij private, në familje, në banesë ose në letërkëmbim vetjak, as sulmit kundër nderit dhe dinjitetit të tij. Secili ka të drejtë të mbrohet me ligj kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla”⁴⁷. “Shteti ka jo vetëm detyrimin negativ për të mos e cenuar këtë të drejtë, por edhe detyrimin pozitiv për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve”⁴⁸.

Kushtetuta e Kosovës përcakton se secili individ gëzon të drejtën për jetë dhe dënimi me vdekje është i ndaluar⁴⁹. Po ashtu, çdo njeri duhet ti garantohet e drejta e mbajtjes të qëndrimeve dhe shprehjen e mendimeve të tij pa ndërhyrje. Kjo e drejtë bazohet në të drejtat elementare të njeriut ku secili ka të drejtë të mbajë qëndrime të caktuara si dhe dhënien dhe marrjen e ideve pa ndërhyrje nga autoriteti publik. Kjo si e drejtë i mundëson edhe licencimin e medieve dhe përcaktimin e kufizimeve me norma ligjore të cilat konsiderohen të domosdoshme për ruajtjen e një shoqërie demokratik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare⁵⁰. “Secili person gëzon të drejtën që të marrë vendime lidhur me reproduktimin, sipas procedurave të përcaktuara me ligj, të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin, të

⁴⁴ DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948, Neni 3.

⁴⁵ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 143.

⁴⁶ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 124.

⁴⁷ DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948, Neni 12.

⁴⁸ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, RAPORT MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2017, Tiranë, 2018, fq. 9.

⁴⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, E Drejta për Jetën, 15 qershor 2008, Neni 25.

⁵⁰ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 126.

drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin, të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore pa pëlqimin paraprak të saj/tij”⁵¹. “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj”⁵².

1.7 Mos-diskriminimi

Fjala diskriminim rrjedh nga Latinishtja e cila ka kuptimin, “ndaj”, “bëj dallim”, “kufizoj të drejtat”⁵³, ose “përdoret për të shënuar trajtimin e padrejtë ose mohimin e privilegjeve normale të personave për shkak të racës, seksit, kombësisë ose fesë”⁵⁴. Parimi i mos diskriminimit nënkupton ndalimin e çdo lloj dallimi, përjashtimi, kufizim apo preferencë që ushtrohet ndaj një apo më shumë personave që bazohet në përkatësin gjinore, moshën, gjendjen martesore, gjuhën amtare, aftësitë e kufizuara mendore apo fizike, orientimin seksual, bindjet politike, përkatësin etnike dhe kombëtare, bindjet, prejardhjen shoqërore dhe familjare, etj. Autoritetet shtetërore duhet të sigurojnë që ky parim të respektohet gjatë veprimeve të tyre, si dhe gjatë aktiviteteve që zhvillohen nga akterët e tjerë brenda Kosovës, përfshirë sferat e punësimit, strehimit dhe mediet⁵⁵.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, obligon shtetet për zbatimin e saj duke mos bërë dallim ndërmjet njerëzve, ngase “gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”⁵⁶. Po ashtu, Kushtetuta e Kosovës e cila ndjek frymën e Konventës potencon se, “askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera,

⁵¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, E Drejta e Integritetit Personal, 15 qershor 2008, Neni 26.

⁵² Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 2.

⁵³ Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Shkup, 2007, fq. 440.

⁵⁴ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 130.

⁵⁵ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 122.

⁵⁶ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 14.

prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”⁵⁷. Sipas Ligjit kundër diskriminimit në Kosovës, “Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës”⁵⁸. Sipas këtij Ligji Institucionet publike janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij Ligji. Në kohën bashkëkohore kur përballemi me forma të ndryshme të diskriminimit në përgjithësi, një fenomen në rritje i bullizmit-ngacmimit është në rritje dhe si i tillë ka marrë përmasa pothuajse globale. Duke u bazuar në format e diskriminimit që mund të ndodhin sidomos ndaj fëmijëve, Ligji për mbrojtjen e fëmijës i bënë përgjegjës, “të gjitha institucionet, ofruesit e shërbimeve, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit”⁵⁹. Kjo dispozitë ligjore i bënë përgjegjës të gjithë ata të cilët në mënyrë direkte apo indirekte kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, madje edhe mos veprimi konsiderohet përgjegjësi penale atëherë kur kemi përgjegjësi dhe mundësi në parandalimin e abuzimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut.

⁵⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Barazia para Ligjit, 15 qershor 2008, Neni 24.

⁵⁸GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 16/26 qershor 2015, PRISHTINË, LIGJI Nr. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, Neni 2.

⁵⁹GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 14/17 KORRIK 2019, PRISHTINË, LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS, Neni 8, Paragrafi 1, 2, 3.

KAPITULLI I DYTË

Korniza Ligjore dhe të Drejtat Themelore të Njeriut në Kosovë

2. Korniza ligjore e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kosovë

Parimet Kushtetuese sa i përket të drejtave të njeriut në Kosovë konsistojnë me parimet ndërkombëtare, dhe si të tilla janë të garantuara për çdo individ pavarësisht prejardhjes. Parimet bazë kushtetuese janë, “parimi i univerzalitetit të të drejtave të njeriut dhe qytetarit, parimi i përjashtimit të kufizuar arbitrar të lirive dhe të drejtave të njeriut, parimi i plotësimit të standardeve ndërkombëtare, parimi se të drejtat e njeriut dhe qytetarit janë rregull kushtetues, parimi i mos diskriminimit, parimi i barazisë së plotë të qytetarëve, parimi i ndarjes së lirive dhe të drejtave të qytetarëve në liri personale, liri dhe të drejta sociale, kulturore, arsimore dhe të drejta dhe liri politike të qytetarëve”⁶⁰.

Të gjitha lirit dhe të drejta e njeriut duhet të sigurohen dhe të mbrohen për secilin qytetarë pavarësisht grupit apo prejardhjes së tij etnike⁶¹. “Promovimi dhe zbatimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve të Kosovës është i rregulluar me akte të ndryshme legjislativë civile dhe penale, duke përfshirë pakon e legjislacionit të të drejtave të njeriut”⁶². Liria e individit nënkupton që secili të sillet në një mënyrë tjetër, ndërsa të drejtat janë autorizime të cilat u njihen njerëzve dhe qytetarëve me kushtetutë, ligj apo ndonjë akt tjetër juridik nacional apo ndërkombëtar. Ndërsa mohimi i të drejtave nënkupton që qytetarët të mos shfrytëzojnë, të mos realizojnë të drejtat e garantuara me ligj apo me ndonjë akt të përgjithshëm. Përkatësisht mohimi i të drejtave shprehet në rast kur qytetari në tërësi është privuar nga e drejta⁶³.

Sipas Kushtetutës parimet e përgjithshme të drejtave themelore të njeriut “janë të pandashme, të patjetërsueshme, të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Kosovës. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe çdokush e ka për

⁶⁰ Arsim Bajrami, *Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës)*, Prishtinë, 2007, fq. 121.

⁶¹ Jonusz Bugajski, *Ngritja e Kosovës, Artikuj dhe fjalime nga okupimi deri te pavarësia*, Prishtinë, 2006, fq. 240.

⁶² ERAC – EQUAL RIGHTS FOR ALL COALITION, *STRATEGJIA E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË 2016—2022: Një rrugë që duhet ndjekur*, Shtator 2016, fq. 9.

⁶³ Ismet Salihu, *Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës)*, Prishtinë, 2006, fq. 162, 165.

detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të tjerëve⁶⁴. "Ligjet të cilat përbëjnë bazën themelore dhe të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt mbrojnë dhe avancojnë të drejtat themelore të njeriut por jo vetëm, konsiderohen të jenë, Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji për Barazinë Gjinore dhe Ligji mbi Avokatin e Popullit, janë vetëm një pjesë e ligjeve në sistemin e gjerë ligjor në Kosovës, të cilët janë përgjegjës për respektimin dhe avancimin e të drejtave të Njeriut"⁶⁵.

Përgjegjësia për respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut konsiderohet si për nivelin qendror po ashtu edhe për atë lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale potencon qartë se, "të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës, t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër"⁶⁶. Po ashtu, sipas Ligjit për Financa dhe Ligjit për Arsimin Parauniversitar, "komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive⁶⁷, për aq sa ato i takojnë interesit lokal⁶⁸, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm"⁶⁹.

2.1 Liria e Shprehjes

Liria e shprehjes është njëra ndër të drejtat elementare të garantuar për njeriun, e cila përfshin të drejtën për tu shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. "Liria e shprehjes është e drejtë themelore, e cila

⁶⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II, Të Drejtat dhe Liritë Themelore, Parimet e Përgjithshme, 15 qershor 2008, Neni 21.

⁶⁵ Francisco Jose & Garcia Martinez & Umberto Cucchi, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Një sistem i shfrytëzuar pak: Gjendja e Kornizës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Prishtinë, 2017, fq. 5.

⁶⁶ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/PRISHTINË: VITI III/Nr. 28/04 QERSHOR 2008, LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Neni 4, Paragrafi 4.2.

⁶⁷ Kompetencat komunale, donë të thotë kompetencat të cilat u janë dhënë komunave sipas legjislacionit të aplikueshëm themelor mbi vetëqeverisjen lokale. Shih, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/PRISHTINË: VITI III/Nr. 27/03 QERSHOR 2008, LIGJI NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, Neni 1.

⁶⁸ "Komunat do të pranojnë një Grand Specifik për Arsim dhe një Grand Specifik për Shëndetësi". Shih, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/PRISHTINË: VITI III/Nr. 27/03 QERSHOR 2008, LIGJI NR. 03/L-049 PËR FINANCAT E PUSHETIT LOKAL, Neni 25.

⁶⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-068 PËR ARSIMIN NË KOMUNATE REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Neni 4, Paragrafi 4.1.

ndërkombëtarisht është kualifikuar si e drejtë kornizë. Liria e mendimit është e drejtë absolute e çdo qytetari, që nënkupton se askush nuk mund ta rrezikojë dhe kufizojë të menduarit e njeriut, ndërsa liria e shprehjes së mendimit konsiderohet si e drejtë politike⁷⁰. “Liria e shprehjes mund të kufizohet vetëm me ligj, në raste se një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në bazë të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Këto të drejta mund të kufizohen vetëm në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme, në përputhje të plotë me dispozitat e Kushtetutës dhe ligjit. Kufizimi i këtyre të drejtave nuk mund të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, racës, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose sociale, pozitës pronësore ose shoqërore”⁷¹.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut thekson se liria e shprehjes “përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë”⁷². Konventa nuk parasheh dispozita ndaluese për shtetet të cilat rregullojnë dhe në të njëjtën kohë kërkojnë licencimin e medieve të shkruara dhe elektronike. “Në shoqëritë demokratike si barometër matës në shumicën e rasteve për lirinë e shprehjes konsiderohen mediet, ngase përmes tyre dhe organizatave jo qeveritare transmetohet zëri i vërtet i të pakënaqurve brenda një shoqërie. Edhe pse disa media të pavarura kanë shprehur pikëpamjet e tyre pa kufizime, edhe pse ka pasur raportime për presion verbal nga zyrtarë qeveritarë, parti politike, biznese, grupet fetare ndaj pronarëve të medieve, redaktorëve dhe reporterëve për të mos publikuar storie apo materiale të caktuara”⁷³.

Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, “shumë gazetarë ankoreshin se pronarët dhe drejtuesit e medieve i parandalonin prej publikimit ose transmetimit të storieve që kritikonin qeverinë, partitë politike ose zyrtarët e caktuar për shkak të parapëlqimeve të pronarëve, ose për shkak të lidhjeve me personat e cekur. Në disa raste, thuhet se pronarët kishin kërcënuar t’i

⁷⁰ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 191.

⁷¹ Sandra Buzlieva & Mila Isakovska, MANUAL PËR LIRINË E SHPREHJES-ASPEKTE JURIDIKE, Shkup, 2016, fq. 11.

⁷² Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 10.

⁷³ Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2015, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, RAPORTI I VITIT 2015 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË. https://photos.state.gov/libraries/kosovo/312585/2016/HRreport2015_alb.pdf, Vizituar më: 10. 02. 2020.

pushonin nga puna gazetarët nëse nxirrnin storie që kritikonin qeverinë dhe grupet e caktuara të interesit të lidhura me politikën. Disa gazetarë ankoheshin se pronarët i ndalonin ata që të prodhonin storie për korrupsionin e nivelit të lartë në qeveri”⁷⁴.

Liria e shprehjes ka qenë dhe akoma vazhdon të jetë sfiduese për faktin se, jo çdo herë dhe çdo njëri ka gximin të shprehë atë që mendon, si pasojë e ndëshkimit apo masave të ndryshme që mund të merren ndajë tij. Ky fenomen vazhdon të jetë sidomos në vendet dhe shtetet në të cilat qeverisja nuk është demokratike, apo si në rastin e Kosovës me demokraci të pa konsoliduar, ndërhyrje politike, shantazhe, niveli i lartë i korrupsionit, mos efikasitetit i prokurorisë dhe gjykatave, etj. Të gjithë këta faktor kanë ndikuar që liria e shprehjes akoma të jetë sfiduese në kuptimin e plotë të fjalës si njëra ndër të drejtat themelore të njeriut.

2.2 Liria e mendimit, besimit dhe fesë

E drejta e lirisë së mendimit, besimit dhe fesë, është një nga të drejtat themelore të domosdoshme për një shtet dhe shoqëri demokratike. Këto të drejta janë absolute, që nënkupton edhe të drejtën e njeriut për të ndryshuar fenë dhe besimin. Prandaj, është e drejtë e secilit që të mos tregojë mendimin e vet, respektin apo besimin në një fe të caktuar. Njëkohësisht, askujt nuk mund ti kërkohet të mendojë, besojë apo të ndjek një besim të caktuar⁷⁵. Sipas Kushtetutës në Kosovës nuk ka religjion shtetëror të përcaktuar, mirëpo, çdo njeri gëzon të drejtën e plotë të shprehjes së liri të mendimit, besimit/fesë, po ashtu, gëzon mbrojtje shtetërore në ushtrimin e kësaj të drejte. Kjo e drejtë është në harmoni të plotë me deklaratën universale për të drejtat e njeriut, ku sipas saj “secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe fesë, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht fenë a bindjen e vet, përmes arsimit, praktikës, kryerjes së kultit dhe riteve fetare”⁷⁶.

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 195.

⁷⁶ DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948, Neni 18.

Përcaktimi kushtetues i Kosovës në aspektin zyrtarë për çështjen e besimit apo një religjioni të caktuar, thekson qartë se “është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare”⁷⁷. “Çdo njeri gëzon të drejtën e mbajtjes së një qëndrimi pa ndërhyrje, si dhe të drejtën e shprehjes së mendimit. Kjo e drejtë nënkupton të drejtën për të mbajtur qëndrime dhe për të marrë dhe dhënë informata dhe ide, pa u penguar nga autoriteti publik. Kjo e drejtë nuk do ta parandalojë licencimin e medieve elektronike dhe përcaktimin me ligj të kufizimeve që janë të domosdoshme për ruajtjen e një shoqërie demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare”⁷⁸.

E drejta e besimit dhe fesë nënkupton lirin e plotë të individit të besojë dhe praktikojë një religjion të caktuar, qoftë i vetëm apo në bashkësi, publikisht apo privatisht, përmes aderimit, mësimdhënies, praktikës fetare të cilat mund t’i nënshtrohen vetëm kufizimeve të cilat janë të paracaktuara me ligj dhe si të tilla janë të nevojshme për ruajtjen e qetësisë publike dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Po ashtu, objektet fetare të gjitha religjioneve dhe monumentet kulturore dhe historike gëzojnë mbrojtje të veçantë shtetërore⁷⁹, duke ndërmarrë masa mbrojtëse për garantimin e sigurisë së tyre⁸⁰. “Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve”⁸¹.

3. Privimi i kundërligjshëm i lirisë

Duke u bazuar në ligjshmërinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, askush nuk mund të arrestohet, ndalohet, internohet arbitrarisht, për faktin se çdo person i akuzuar për një vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet pafajësia e tij gjatë një procesi gjyqësor

⁷⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Shteti Laik, 15 qershor 2008, Neni 8.

⁷⁸ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 126.

⁷⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Trashëgimia Kulturore dhe Fetare, 15 qershor 2008, Neni 9.

⁸⁰ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 129.

⁸¹ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 9.

publikë, duke iu garantuar të gjitha të drejtat sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar⁸². Kodi i Procedurës Penale i Kosovës thekson qartë se, “çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës”⁸³. “Funksioni kryesor i së drejtës penale është mbrojtja e individit dhe shoqërisë nga sjelljet me të cilat cenohen liritë dhe të drejtat individuale dhe funksioni i përbashkët i jetës, apo me fjalë të tjera, funksioni mbrojtës i së drejtës penale është mbrojtja e shoqërisë nga kriminalitetit”⁸⁴. Problemi kryesor i mbrojtjes penale juridike të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, është konflikti në mes të drejtave themelore të njeriut dhe interesave të shtetit dhe shoqërisë⁸⁵.

Për të hetuar një çështje penal, para se gjithash duhet pasur parasysh të drejtat dhe liritë themelore të njeriut⁸⁶, ngase askush nuk mund dhe nuk duhet të arrestohet, burgoset, apo të dëbohet arbitrarisht⁸⁷. Madje, “askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që në momentin kur është kryer, nuk përbënte veprë penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej veprë penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara”⁸⁸.

Kushdo që personin tjetër e burgosë në mënyrë të kundërligjshme, e mban të mbyllur ose në ndonjë mënyrë tjetër e privon nga liria konsiderohet veprë penale. Vepra penale konsiston në atë, “nëse e burgosë në mënyrë të kundërligjshme, duke e mbajtur të mbyllur ose në ndonjë

⁸² Ejup Sahiti, Revista “E Drejta”, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Procesi i të Provuarit në Procedurën Penale-Mundësit dhe Veshtërsit, Prishtinë, 1996, fq. 38.

⁸³ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 37/28 DHJETOR 2012, PRISHTINË KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE, Neni 3.

⁸⁴ Vllado Kambovski & Ismail Zejneli, E Drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2018, fq. 21.

⁸⁵ Rexhep Murati, Rishikimi i Procedurës Penale për shkak të fakteve dhe provave të reja, Prishtinë, 2006, fq. 26.

⁸⁶ Hashim Çollaku, Revistë “E Drejta” – Law, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Nr. 1–2012, Fillimi, qëllimi dhe zbatimi i hetimit, Prishtinë, 2012, fq. 115.

⁸⁷ DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948, Neni 9.

⁸⁸ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 7.

mënyrë tjetër duke e privuar nga liria”⁸⁹. Kjo nënkupton se procedura penale është mjet për mbrojtjen e qytetarëve, të drejtat e të cilëve dëmtohen ose rrezikohen, të cilëve u mundësohet që në situata të caktuara edhe vetë të iniciojnë procedurën penale në cilësi të paditësit subsidiar ose privat. “Tendenca për mbrojtje të drejtave të qytetarëve të pandehur, duke iu kundërvënë tendencës për efikasitet të procedurës penale synon që qytetarëve, ndaj të cilëve zhvillohet procedura penale, të cilët ndoshta janë të pafajshëm në procedurën penale, të mos u kufizohen të drejtat personale pa arsye si edhe të drejtat në mbrojtje, ose të dënohen, ndonëse nuk janë përgjegjës për vepra penale”⁹⁰.

Forma e rëndë e veprës penale konsiderohet nëse është kryer në këto raste: “Nëse privimi i kundërligjshëm nga liria zgjatë më shumë se tridhjetë ditë, nëse vepra është kryer në mënyrë mizore, nëse privimi nga liria ka shkaktuar dëmtime të rënda të shëndetit, nëse ka shkaktuar pasoja tjera të rënda”⁹¹. Në përpjekje për arritjen e ekuilibrit në fjalë, mund të thuhet se procedura është një veprimtari e atillë në të cilën me aktivitetin e organeve shtetërore, vërtet shkelen shumë të drejta e nganjëherë edhe lirit e qytetarëve, prandaj shpeshherë është vështirë të gjenden zgjidhje të atilla që sa më pak të cenohen të drejtat dhe liritë e qytetarëve, e njëherësh të sigurohet efikasiteti i procedurës penale.

4. Tortura

Në kriminologji si shkencë mbi fenomenologjinë dhe etiologjinë e kriminalitetit, qysh herët është përvetësuar mendimi se për luftimin e suksesshëm të kriminalitetit, në radhë të parë, duhet të bëhet hulumtimi dhe prezantimi i shkaqeve dhe rrethanave të cilat kanë kushtëzuar atë. Ngase për luftimin e çdo dukurie negative në shoqëri, pra edhe të veprave penale, në radhë të parë është e domosdoshme të hulumtohen, analizohen dhe të prezantohen shkaqet dhe

⁸⁹ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 171.

⁹⁰ Rexhep Murati, Revistë “E Drejta”, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Efikasiteti i Procedurës Penale dhe Mbrojtja e të Drejtave dhe Lirive të të Pandehurit në Procedurën Penale, Prishtinë, 1996, fq. 115, 116.

⁹¹ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 172, 173.

rrethanat të cilat e kanë kushtëzuar kriminalitetin në përgjithësi⁹². “Tortura si mjet për fitimin e pohimit të pandehurit është zbatuar një kohë të gjatë. Mirëpo, meqenëse mundësia për t’i përballuar torturës nuk varet nga fakti se i pandehuri është i pafajshëm, por pikësëpari nga konstitucioni trupor dhe qëndrueshmëria e nervave të tij, rezultati i zbatimit të kësaj mase drastike gjatë disa shekujve ka qenë ai se shumë njerëz të pafajshëm kanë qenë të munduar rëndë dhe të gjykuar me vdekje, ndërsa shumë fajtorë të njëmendët i kanë shpëtuar dënimit”⁹³.

“Tortura në procedurën penale nënkupton mënyrën e hetimit në të cilën deklaratat nxirren me dhunë, duke shkaktuar dhembje dhe vuajtje, edhe pse tortura në të vërtet mund t’i nënkuptoj të gjitha format e mundimit dhe format barbare të likuidimit. Tortura si mjet ka evoluar që nga mesjeta deri në kohën bashkëkohore. Në kohën bashkëkohore tortura më së shpeshti i shmanget formave të vrazhda të sakatimit. Ajo më tepër orientohet në drejtim të futjes sa më të thellë në shpirtin e personit i cili merret në pyetje, duke kërkuar nga ai sa më tepër rrëfime, duke e ndarë nga jeta në të cilën bënte pjesë dhe duke e bindur në pavlerësin e tij”⁹⁴. “Mënyrat e torturës janë nga më të ndryshmet, si qëllim për arritjen e të vërtetës nëpërmjet metodës së shokut, dhe pikërisht nëpërmjet elektroshokut duke e lëshuar energjinë elektrike, pastaj nëpërmjet insulinë shokut, me zbritje të përnjëhershme të nivelit të sheqerit në gjak. Kësisoj shkaktohet dezorientimi, harresa, sugjestibiliteti të personi ndaj të cilit është zbatuar shoku, megjithatë arrihet deri të deklarata jo e sigurt”⁹⁵.

Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, “askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës, a trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”⁹⁶. Po ashtu, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në Nenin 7 thekson se, “asnjëri nuk mund t’i

⁹² Bajram Ukaj, Revistë “E Drejta”, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Vështrime të caktuara lidhur me disa faktorë të përgjithshëm etiologjikë të veprave penale kundër sigurisë në komunikacionin automobilistik, Prishtinë, 1996, fq. 133.

⁹³ Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Shkup, 2017, fq. 14.

⁹⁴ Ejup Sahiti, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Dëshmia e Dëshmitarit si Provë në Procedurën Penale, Prishtinë, 1993, fq. 203, 204.

⁹⁵ Po aty, fq. 203, 204.

⁹⁶ DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948, Neni 5.

nënshtrohet torturës, dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore e degraduese”⁹⁷. Tortura si mjet dhe fenomen për arritjen dhe fitimin e pohimit të të pandehurit është zbatuar një kohë të gjatë. Mirëpo, mundësia për ti përballuar torturës nuk varet nga fakti se i pandehuri është i pafajshëm, por nga konstitucioni trupor dhe qëndrueshmëria e nervave të tij, rezultati i zbatimit të kësaj mase drastike gjatë disa shekujve ka qenë ai se shumë njerëz të pafajshëm kanë qenë të munduar rëndë dhe të gjykuar me vdekje, ndërsa shumë fajtorë të njëmendë i kanë shpëtuar dënimit⁹⁸.

Përdorimi i torturës sipas të drejtës kushtetuese dhe ligjore konsiderohet e ndaluar kur tortura përdoret si mjet i dhunës⁹⁹ me qëllim të nxjerrjes së informatave vetinkriminuese. Madje ky është parim ndërkombëtar dhe kushtetues se “askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”¹⁰⁰. Përdorimi i torturës është e ndaluar me ligj dhe konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut dhe të qytetarit. Si rrjedhojë, çdo formë e torturës e cila ka për qëllim detyrimin për pranimin e fajësisë apo pafajësisë nëpërmjet deklaratës duke përdorur si mjet mundimin apo ndëshkimin ose pa lejen e tij apo të sajë të bëhen eksperimente medicinale apo shkencore¹⁰¹. Për ndriçim dhe zgjidhje të një çështjeje juridiko penale, është e domosdoshme që në procedurë penale të merren veprime procedurale me ndihmën e të cilave gjykata, duke i konsideruar rrethanat e ngjarjes në përputhje me ndodhitë reale, duhet të konstatojë të vërtetën në procedurën penale¹⁰².

⁹⁷ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Miratuar nga Asambleja e OKB-së me Rezolutën 2200 A(XXI), të datës 16 dhjetor 1966, hyrë në fuqi, më 23 mars 1976, Neni, 7.

⁹⁸ Ejup Sahiti, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2005, fq. 13.

⁹⁹ Dhunë në familje nënkupton: “përdorimin e forcës fizike ose psikike, shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimit e dinjitetit, sulmi fizik, ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues, marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual, kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes, hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër, rrëmbimi”. Shih, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/PRISHTINË: VITI V/Nr. 76/10 GUSHT 2010, LIGJI Nr. 03/L-182 PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE, Neni 2.

¹⁰⁰ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 3.

¹⁰¹ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 124.

¹⁰² Ejup Sahiti, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Dëshmia e Dëshmitarit si Provë në Procedurën Penale, Prishtinë, 1993, fq. 13.

5. Cenimi i paprekshmërisë së banesës

Banesa si vendbanim dhe pronë private konsiderohet e paprekshme, dhe përcaktohet me dispozita ligjore se personat zyrtar mund të hyjnë në banës vetëm me vendim të gjykatës kundër vullnetit të pronarit të tyre, dhe në to të bëjnë kontroll sipas nevojës së paraqitur. Po ashtu, kontroll mund të bëhet vetëm atëherë kur të pranishëm janë dy dëshmitarë. Por, në raste specifike në banës personi zyrtar mund të hyjë pa vendim të gjykatës vetëm atëherë kur është e domosdoshme për të zënë kryesin e veprës penale ose për të shpëtuar njerëzit dhe pasurin¹⁰³. “Mundësia e hyrjes së policisë në banesë të zbatojë kontrollin pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake është: nëse personi përkatës me vetëdije dhe vullnet pajtohet me kontrollin, personi kërkon ndihmë, personi i gjetur në flagrancë duhet të arrestohet, kur këtë e kërkojnë arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe të pasurisë dhe kur personi për të cilin është lëshuar urdhër arresti nga gjykata gjendet në shtëpi apo lokale të tjera”¹⁰⁴.

Përrjashtimisht cenim i banesës nuk konsiderohet kur “kontrolli i banesës dhe i lokaleve të tjera të të pandehurit dhe të personave tjerë, si masë për gjetjen e personave dhe provave materiale, mund të ndërmerret kur besohet se me kontrollim i pandehuri do të kapet ose do të gjenden gjurmët e veprës penale ose sendet e rëndësishme për procedurë penale. Kontrolli mund të bëhet edhe në lokalet e organeve shtetërore dhe në lokalet e personave juridikë, me ç’rast thirret eprori i tyre që të asistojë gjatë kontrollit”¹⁰⁵. Hyrja në mënyrë të kundërligjshme nënkupton hyrje me dhunë, përdorimi i forcës fizike me qëllim të evitimit të pengesave fizike apo zotërimin e rezistencës së personit të autorizuar. “Po ashtu, hyrja e kundërligjshme në banesën e huaj mund të bëhet edhe pa e përdorur forcën, por me çelësin origjinal të vjedhur më parë nga pronari i banesës. Vepra penale konsiderohet se është kryer me faktin e hyrjes në banesën apo objektin e huaj të mbyllur, apo duke mos dalë jashtë nga to me kërkesën e personit të autorizuar”¹⁰⁶.

¹⁰³ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 127.

¹⁰⁴ Ejup Sahiti, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2005, fq. 126.

¹⁰⁵ Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Shkup, 2017, fq. 146.

¹⁰⁶ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 177.

Raporti i Monitorimit të OSBE-së shpalosë se rastet e cenueshmerisë së vendbanimeve-banesave në mënyrë të paligjshëm në Kosovë, vë në dukje se rastet e tilla nuk po trajtohen nga gjyqësori dhe prokuroria në mënyrën e duhur. Këto raste nuk ishin hetuar shpejt, ndjekur penalisht në mënyrën e duhur apo shqyrtuar nga gjykatat në kohë, dhe sanksionet e vendosura nuk ishin të mjaftueshme për të qenë mjet juridik¹⁰⁷. Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) i ka shqyrtuar pothuajse të gjitha kërkesat pronësore që kishin rezultuar, gjithsej 42,749 raste. Megjithatë, afro 540 raste janë ende në procedurë të ankimimit pranë Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës. Sidoqoftë, përparim i paktë është bërë lidhur me aftësinë e AKP-së, Policisë së Kosovës dhe të Gjyqësorit për t'i zbatuar këto vendime dhe shumë prona u cenuan shpejt në mënyrë të paligjshme. Nga cenueshmeria e paligjshme janë prekur më së shumti personat e zhvendosur të cilët kanë qasje të kufizuar në pronat e tyre, dhe atyre u duhet ta paguajnë tatimin në pronë të akumuluar për pronat e uzurpuara në mënyrë të paligjshme që nuk i kanë në posedim¹⁰⁸. Prej të gjitha mjeteve provuese dhe provave që mund të përdoren në procedurën penale, është e rëndësishme dëshmitari dhe dëshmia e tij si provë në procedurën penale. Dëshmia e dëshmitarit bënë pjesë në grupin e provave personale, burim i të cilave është vetë njeriu.

Fenomeni i cenueshmerisë së banesës sidomos pas përfundimit të luftës ka qenë njëra ndër sfidat kryesore për autoritet vendore dhe ato ndërkombëtare. Me kalimin e kohës dhe me vendosjen e bazave ligjore si dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, pothuajse shumica e pronave të cenueshme u janë kthyer pronarëve të tyre, fatkeqësisht, kthimi i pronave nuk ka ndodhur tërësisht në disa Komuna të Kosovës, më konkretisht në Mitrovicë në pjesën Veriore të banuara kryesisht me popullsi shumicë serbe. Nga të dhënat e raportuara në Raportet e OSBE-së shohim se është bërë përparim i dukshëm, por numri i lëndëve të pazgjidhura fatkeqësisht akoma mbetet shqetësuese, kur kihet parasysh se mohimi i rikthimit apo gezimit të drejtës pronësore është në kundërshtim me konventat Ndërkombëtare, Kushtetutën dhe Ligjet e Kosovës.

¹⁰⁷ OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË, Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve Botimi i katërt, Nëntor 2015, fq. 14.

¹⁰⁸ OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË, Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve Botimi i katërt, Nëntor 2015, fq. 15.

6. Parandalimi i ushtrimit të drejtës së votimit

Sipas Konventave Ndërkombëtare, Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, çdo qytetarë i Kosovës pavarësisht prejardhjes së tij, ka të drejtë të zgjedh dhe të zgjedhet në organet e pushtetit, si anëtarë i asambleve komunale, deputet në Kuvendin e Kosovës dhe në organet e tjera shtetërore. Në këtë aspekt mbrohet e drejta e qytetarëve e cila është e rëndësishme për konstituimin e organeve demokratike dhe legjitime¹⁰⁹. “E drejta e votimit që i është dhënë secilit prej nesh për zgjedhjen e zyrtarëve të shtetit lind nga ligji pozitiv që përcakton mënyrën se si duhet të zbatohet e drejta natyrore e popullit për vetëqeverisje në një shoqëri demokratike”¹¹⁰. E drejta për votim nënkupton lirin dhe të drejtën e çdo qytetari të vendos se për kë të votojë. “Korniza ligjore e cila rregullon organizimin e procesit zgjedhor në Kosovë përbëhet nga Kushtetuta e Kosovës, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Zgjedhjet Lokale, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike si dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës”¹¹¹.

Askush nuk ka të drejtë që t’i detyrojë qytetarët të realizojnë këtë të drejtë (të votojnë) e as nuk ka të drejtë të ndikojë se si të votojë. Asnjë qytetarë nuk është i obliguar t’u tregojë se si ka votuar si dhe askush nuk mund t’i thërras në përgjegjësi se si kanë votuar. Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në ndikimin e vullnetit të votuesve që të votojnë në mënyrë të caktuar apo të mos votojnë. “Si mjete të cilat në shumicën e rasteve përdorën janë dhuna, kanosja serioze, dhënia e ryshfetit, keqpërdorimi i varësisë ekonomike apo profesionale. Pasoja e kësaj vepre penale është cenimi i lirisë së votimit apo lirisë së përcaktimit të votuesve”¹¹². Sipas Kodit Penal të Kosovës, “kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pengon ose ndërpre në procesin e votimit, dënohet me burgim prej një (1) deri në dy (2) vjet. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, pengon votimin me nxitje të prishjes së rendit

¹⁰⁹ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 190, 191.

¹¹⁰ Jacques Maritain, Njeriu dhe Shteti, Tiranë, 2000, fq. 138.

¹¹¹ Demokracia në Veprim, Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 11 qershor 2017, RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE, Prishtinë, 2017, fq. 10.

¹¹² Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 192.

publik në qendrën e votimit, që rezulton me ndërprerje në procesin e votimit, dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në tre (3) vjet¹¹³.

Kryerësi i kësaj vepre penale konsiderohet të jetë personi zyrtarë të cilit i janë besuar detyra të caktuara për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në nivele komunale dhe qendrore. Këta janë persona të cilët janë të angazhuar në përpilimin e listave të votuesve, mandej persona në komisionet komunale dhe parlamentare të zgjedhjeve si dhe persona të cilët janë të angazhuar në qendrat e votimit që ti numërojnë votat. Sipas kësaj, “vepra penale konsiderohet se është kryer kur ndonjë personi i është bërë e pamundur ta ushtrojë të drejtën elektorale që të votojë. Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje direkte e cila përfshin në vete edhe qëllimin që t’i pamundësohet personit tjetër që të votojë”¹¹⁴.

Në zgjedhjet e vitit 2017, sipas demokracisë në veprim, “përdorimi i dhunës apo kërcënimeve ndaj votuesve, anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve apo vëzhguesve është raportuar në 20 vendvotime. Komunitatet ku është raportuar për raste të tilla janë Ferizaj (4 raste), Gjakovë (3 raste), Mitrovicë (2 raste), dhe 11 komuna të tjera (nga 1 rast)”¹¹⁵. Shikuar në tërësi, duke u bazuar në të drejtën elementar atë të votimit, si parim elementarë i demokracisë dhe të drejtave të njeriut, mohimi apo cenimi i ushtrimit të kësaj të drejte konsiderohet ndërhyrje flagrante dhe cenim i të drejtave të njeriut.

7. Cenimi i fshehtësisë së votimit

Fshehtësia në procesin e votimit nënkupton lirin e plotë të çdo qytetari që për mënyrën e votimit të tjerët mos të dinë se si ka votuar. “Fshehtësia e votës është një prej standardeve të zgjedhjeve që duhet plotësuar, ngase u mundëson votuesve të hedhin votën e tyre në pavarësi të plotë. Mbrojtja e fshehtësisë së votës e bën kërcënimin ose rryshfetin shumë më pak

¹¹³ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 2/14 JANAR 2019, PRISHTINË, Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, Neni 214.

¹¹⁴ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 191.

¹¹⁵ Demokracia në Veprim, Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 11 qershor 2017, RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE, Prishtinë, 2017, fq. 30.

efektiv”¹¹⁶. Me garantimin e fshehtësisë së votimit, sigurohet liria e votuesit që lirshëm të përcaktohet, të vendosë se për kë do të votojë¹¹⁷. Kjo parashihet qartë edhe në Kodin Penal të Kosovës në të cilin specifikisht përcaktohet se, “kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, ose me keqpërdorim të varësisë ekonomike dhe profesionale të votuesit ndikon ose detyron votuesin në Republikën e Kosovës që të votojë në mënyrë të caktuar ose të mos votojë në zgjedhje, dënohet me një (1) deri në pesë (5) vjet burg”¹¹⁸.

Në raportin zgjedhor të Organizatës Demokracia në Veprim sa i përket fshehtësisë së votimit në procesin zgjedhor në Kosovë konstaton se, “votimi jashtë kabinës së votimit apo votimi i hapur mund të interpretohet edhe si shprehje e lojalitetit ndaj subjektit politik që buron nga frika apo kërcënimi për të votuar në mënyrë të caktuar. Nga të gjitha 2,490 vendvotimet e hapura në vend, vëzhguesit e Demokracisë në Veprim kanë raportuar se në 48 prej tyre ka pasur votime jashtë kabinave të votimit, që shprehur në përqindje i bie që kjo dukuri është manifestuar në 1.93 % të tyre”¹¹⁹. Cenimi i fshehtësisë së votimit mund të kryhet me veprime të ndryshme me të cilat në mënyrë të paautorizuar merret vesh, zbulohet si ka votuar ndonjë person si p.sh. duke vënë ndonjë shenjë në fletëvotim dhe duke shikuar më vonë si ka votuar personi i caktuar, duke vështruar në mënyrë të fshehtë, duke mos i siguruar kushtet për votim të fshehtë me qëllim që të merret vesh si ka votuar personi apo personat e caktuar¹²⁰.

Kodi Penal i Kosovës parashihet masa ndëshkuese për secilin që në një mënyrë apo tjetër vërtetohet që ka ndikuar në cenimin e fshehtësisë së votimit. “Kushdo që në zgjedhje ose në referendum cenon fshehtësinë e votimit, dënohet me burgim deri në gjashtë (6) muaj. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme kërkon nga personi që të tregojë si ka votuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit. Kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë

¹¹⁶Po aty, fq. 26.

¹¹⁷ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 193.

¹¹⁸ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 2/14 JANAR 2019, PRISHTINË, Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, Neni 210.

¹¹⁹ Demokracia në Veprim, Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 11 qershor 2017, RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE, Prishtinë, 2017, fq. 28.

¹²⁰ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 193.

person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij në zgjedhje ose në votim, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet¹²¹. Vepra penale konsiderohet se është kryer me faktin e cenimit të fshehtësisë së votimit. Kryerësi i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, përveç votuesit i cili vetë e cenon fshehtësinë e vetë të votimit¹²².

8. Mashtrimi në votime

Mashtrim apo fshehje në procesin e votimit nënkupton, veprim me të cilin pamundësohet ose vështirësohet gjetja apo qasja në dokumentet e zgjedhjeve, përkatësisht të votimit. Në rastin e Kosovës “në praktikë në të kaluarën për rastet e zgjedhjeve rezulton se kanë dështuar tri hallkat e sistemit të drejtësisë, përfshirë policinë, prokuroritë dhe gjykatat”¹²³. Përkufizimet si dëmtimi, nënkupton veprimin me të cilin dokumentet e votimit shndërrohen në aso gjendje e cila e vështirëson shfrytëzimin e tyre. Ndërsa, me marrje nënkuptojmë veprimin me të cilin dokumentet e votimit transferohen nga vendi ku duhet të gjenden në vende të tjera¹²⁴. “Kushdo që kryen një ose më shumë nga veprat në vijim, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet: voton ose tenton të voton në emër të personit tjetër; voton ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë; shfrytëzon më shumë se një listë votimi”¹²⁵.

Korniza ligjore për ndëshkimin e manipuluesve dhe abuzuesve të votave gjatë procesit zgjedhor, bazohet në dispozitat ligjore të Kodit Penal të Kosovës. Nenet që sanksionojnë keqpërdorimet në zgjedhje janë 176, 177, 178, 179, 180, dhe 181 të Kodit Penal të Kosovës. “Përmes këtyre veprave penale dënohen të gjithë personat të cilët në çfarëdo mënyre pengojnë votuesit që të ushtrorjnë të drejtën e votës, që ndërmarrin çfarëdo veprimtarish korruptive apo

¹²¹ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 2/14 JANAR 2019, PRISHTINË, Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, Neni 215.

¹²² Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 194.

¹²³ KIPRED - Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave, Krimet e Zgjedhjeve Analizë e ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të krimeve të zgjedhjeve në Kosovë, Prishtinë, 2011, fq. 3.

¹²⁴ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 196.

¹²⁵ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 2/14 JANAR 2019, PRISHTINË, Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, Neni 213.

përdorin dhunë në ditën e votimit, votojnë disa herë të njëjtit votues, zbulojnë votën e fshehtë, mashtrojnë në votime dhe asgjësojnë në forma të ndryshme dokumentet e votimit”¹²⁶.

Sipas Raportit mbi zgjedhjet të Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave, “korniza ligjore për ndëshkimin e shkelësve, manipuluesve dhe abuzuesve të votave gjatë procesit zgjedhor në Kosovë bazohet në dispozitat ligjore të Kodit Penal të Kosovës¹²⁷. Në pjesën ku përfshihen veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, gjashtë nene specifike i kushtohen veprave penale që kanë të bëjnë me keqpërdorime të ndryshme të zgjedhjeve. Baza ligjore për ndjekjen penale nuk kufizohet vetëm në këto vepra por shkon edhe më tutje duke i cilësuar ato në një kategori më të rëndë siç është krimi i organizuar, nëse plotësohen kushtet e caktuara ligjore”¹²⁸. Me gjithë faktin se në këto dispozita ligjore është paraparë se kryerësi i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, mirëpo për shkak të natyrës së kësaj vepre, këtë vepër zakonisht mund ta kryejë por jo vetëm, personi apo personat të cilët janë anëtarë të këshillit të votimit apo ndonjë person tjetër të cilit i është besuar ushtrimi i ndonjë detyre gjatë zgjedhjeve¹²⁹ apo votimit¹³⁰.

Dyshimet kryesore për mundësin e mashtrimit në zgjedhje bazohen në faktin se, secili person i cili ka të drejtë vote dhe nuk ka mundësi të ushtrojë këtë të drejtë, qofshin ata jashtë vendi apo ata që zgjedhin të mos votojnë, mbetet mundësia që të tjerët të votojnë në emër të tyre. Kjo

¹²⁶ KIPRED-Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave, Krimet e Zgjedhjeve Analizë e ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të krimeve të zgjedhjeve në Kosovë, Prishtinë, 2011, fq. 15.

¹²⁷ “Çdo person zyrtar të cilit i janë besuar detyra lidhur me zgjedhjet, keqpërdor pozitën, detyrën apo autoritetin e tij duke urdhëruar, këshilluar ose kryer ndonjë vepër të kundërligjshme me qëllim të ndryshimit apo ndikimit të listës së regjistrimit të votuesve ose votimit të cilitdo person ose në ndonjë mënyrë tjetër vepron me qëllim që të ndryshojë, ndikojë ose pengojë ndonjë person nga ushtrimi i të drejtës së tij për të votuar, për të mos votuar, për të hedhur një votë të pavlefshme ose për të votuar në favor apo kundër një personi ose propozimi të caktuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në pesë (5) vjet”. Shih, KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 2/14 JANAR 2019, PRISHTINË, Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, Neni 211.

¹²⁸ KIPRED - Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave, Krimet e Zgjedhjeve Analizë e ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të krimeve të zgjedhjeve në Kosovë, Prishtinë, 2011, fq. 15.

¹²⁹ “Kushdo që shton, heq apo fshin votat apo nënshkrimet, regjistron në mënyrë të pasaktë votën apo rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, ose publikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve apo të votimit që nuk i përgjigjen votimit të vërtetë, ose në ndonjë mënyrë tjetër falsifikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet”. Shih, KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 2/14 JANAR 2019, PRISHTINË, Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, Neni 216.

¹³⁰ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme (Me Kodin Penal të Kosovës), Prishtinë, 2006, fq. 195.

tregon se çdo dalje mbi 60% është teknikisht e pamundur, shumica e zgjedhjeve me pak ose aspak tregues të mashtrimeve raporton dalje me 30-40 %. Ka komuna ku dalja në mënyrë rutinore arrin deri rreth nëntëdhjetë përlind, tregues padyshim i mashtrimeve masive. Zgjedhjet janë karakterizuaa me keqpërdorime dhe manipulime, shkatërrim të fletvotimeve si dhe me falsifikime të rezultateve të votimit. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) i anuloi rezultatet e votimit në 40 Qendra të Votimit dhe rreth 34,000 vota u dërguan me postë¹³¹.

Progresi në zgjidhjen e lëndëve nga Gjykatat Komunale për mashtrim në zgjedhje¹³²

GJYKATA KOMUNALE:	Numri i lëndëve	Numri i personave të akuzuar	Lëndë e Zgjidhur	Persona në lëndë të zgjidhura	Progresi në zgjidhjen e rasteve	Progresi në zgjidhjen e rasteve në bazë të personave
Gjilan	6	12	1	2	17%	17%
Kamenicë	5	10	2	4	40%	40%
Viti	2	2	0	0	0%	0%
Prizren	1	1	1	1	100%	100%
Dragash	1	1	0	0	0%	0%
Pejë	1	3	0	0	0%	0%
Gjakovë	13	78	1	1	8%	1%
Prishtinë	9	10	2	2	22%	20%
Ferizaj	4	18	4	18	100%	100%
Shtërpeç	3	9	2	8	67%	89%
Glogovc	20	128	13	77	65%	60%
Kaçanik	4	24	1	3	25%	13%
Lypjan	2	15	1	1	50%	7%
Skenderaj	6	7	1	1	17%	14%
Vushtrri	1	1	1	1	100%	100%
TOTAL:	78	319	30	119	38%	37%

¹³¹ KFOS - Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur, Seria e analizave “Çka shkoi ters? Top problemet zgjedhore, Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor, Prishtinë, 2015, fq. 9.

¹³² KIPRED-Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave, Krimet e Zgjedhjeve Analizë e ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të krimeve të zgjedhjeve në Kosovë, Prishtinë, 2011, fq. 25.

Procesi zgjedhor në Kosovës në shumicën e rasteve është përciellur me parregullsi të shumta. Kjo ka bërë që edhe zgjidhja e lëndëve të ngritura nga prokuroroina për mashtrim në zgjedhje nuk është bërë në përputhje me qarkoren e nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës, e cila i obligon Gjykatat që ato t'i trajtojnë me prioritet këto raste. Shqetësues mbetet efikasiteti i trajtimit të këtyre rasteve nga gjykatësit, të cilët nuk kanë shënuar rezultate të pritshme në zgjidhjen e këtyre lëndëve. Nga 319 persona të akuzuar për përfshirje në manipulime të zgjedhjeve, gjykatësit kanë shqiptuar dënime ndaj 119 prej tyre. Numri i rasteve të zgjidhura dhe atyre të pazgjidhurave është treguesi më i kjartë se sa Gjykatat kanë qenë efikase në rastet e zgjidhura. Sikurse në zgjedhjet paraprake, edhe në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2019, janë perseritur ankesat e shumta të Partive Politike, anulimi i shumë vendvotimve, rinumërimi i tyre si dhe përsëritja e tyre. Padyshim, shtetet përmes organizimit të zgjedhjeve tregojnë konsolidimin apo mos konsolidimin e demokracisë, dhe për pasojë edhe respektimin e të drejtës së votimit dhe mbrojtjes së sajë nga mundësia e mashtrimit dhe abuzimit.

KAPITULLI I TRETË:

Mbrojtja e Kategorive të Caktuar të Drejtave të Njeriut në Kosovë

9. Të drejtat e fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve ka qenë sfidë për çdo shtet, e sidomos për shtet e sapo formuara dhe në tranzicion. Në aspektin ndërkombëtar duke u bazuar në frymën e parimeve të përcaktuara nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20 nëntor 1959, fillimisht shpalli Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës. Ndërsa në vitin 1979, gjatë vitit ndërkombëtar të fëmijës, u bë një propozim për të zgjeruar këtë deklaratë dhe për ta bërë të obligueshme nën ligjin ndërkombëtar. Në rrjedhën e këtyre përpjekjeve u prezantua drafti i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, u miratua më 20 nëntor 1989 dhe hyri në fuqi më 2 shtator 1990. Konventa e të Drejtave të Fëmijëve është ratifikuar nga 185 Shtete anëtare të OKB-së¹³³.

Janë katër parime të përgjithshme në Konventë të cilat ndihmojnë në interpretimin e Konventës në tërësi siç janë: Mosdiskriminimi, Interesat më të larta të fëmijës, Ekzistenca dhe zhvillimi, Vëmendja ndaj pikëpamjeve të fëmijëve. Konventa konfirmon të drejtat që duhet t'i gëzojnë të gjithë fëmijët si qenie njerëzore, ajo avancoi disa të drejta bazë të njeriut duke marrë në konsideratë nevojat speciale të fëmijëve si dhe vendos standarde të veçanta në fushat të cilat janë specifike dhe të cilat u përkasin fëmijëve¹³⁴.

Konventa Evropiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, u bënë thirrje shteteve të përmbushin përgjegjësit e tyre institucionale dhe shtetërore në relacion me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve¹³⁵. Po ashtu, Konventa Evropiane Për Marrëdhëniet me Fëmijët, duke u bazuar në parimet e së drejtës ndërkombëtare, "fëmija që konsiderohet me zhvillim të plotë mendor ka të drejtë, përveç kur një gjë e tillë do të ishte

¹³³ KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 44/25 të datës 20 nëntor 1989. HYRË NË FUQI: 2 shtator 1990.

¹³⁴ Ismet Elezi & Vasilika Hysi, Politika Kriminale, Tiranë, 2006, fq. 157.

¹³⁵ Sipas Konventës, palët nxiten të forcojnë ligjin në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, të sigurojnë informacione në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, të kërkojnë pikëpamjet e fëmijëve. Shih, Konventa Evropiane Mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, Strasburg, 25.01.1996, Neni 12.

haptazi në dëm të interesave të larta të tij ose të saj, të marrë të gjithë informacionin përkatës, të konsultohet, të shprehë mendimet e tij ose të saj”¹³⁶.

Kushtetuta e Republikë së Kosovës e përcakton qartë mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kapitulli II i Kushtetutës rregullon të drejtat dhe liritë themelore, ndërsa Neni 22 sanksionon zbatimin e drejtpërdrejtë të instrumenteve ndërkombëtare. Ndër 8 instrumentet që listohen aty është edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa Neni 50 i Kushtetutës përcakton të drejtat e fëmijëve. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës është miratuar më 27 qershor 2019 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në Neni 1, thotë, “të mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës”¹³⁷. Ky Ligj sikurse ligjet e tjera sa i përket të drejtave të njeriut, ndjek frymën e Konventës për të drejtat e fëmijës, si dhe tregon rolin e institucioneve në mbrojtjen e fëmijëve, krijimin e mekanizmave dhe masat e veçanta mbrojtëse.

Sipas Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës si dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës të Republikës së Kosovës, me fëmijë nënkupton çdo njeri nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, përjashtimisht rasteve kur mosha madhore e fëmijës arrihet përpara, në përputhje të plotë me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet¹³⁸. Ndërsa fëmijë i mitur konsiderohet mes moshës 14 dhe 18 vjet¹³⁹. Moshë 18 vjeçare shënon edhe zyrtarisht fundin e fëmijërisë në të drejtën ndërkombëtare dhe në aspektin kulturor dhe ligjor në shumë vende të Botës. Shërbimet e mirëqenies së fëmijëve shpesh ndalohen kur fëmijët e arrijnë këtë moshë, veçanërisht ato shërbime të cilat janë ofruara nga organet shtetërore, qoftë në kujdes

¹³⁶Konventa Evropiane Për Marrëdhëniet me Fëmijët, Hagë, 29 maj 1993, Neni 6.

¹³⁷GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 14/17 KORRIK 2019, PRISHTINË, LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS, Neni 3, Paragrafi 1.2.

¹³⁸KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 44/25 të datës 20 nëntor 1989. HYRË NË FUQI: 2 shtator 1990, Neni 1.

¹³⁹Moshë rinore ose “i ri, e re - grupmosha e të rinjve konsiderohet prej pesëmbëdhjetë (15) deri njëzetekatër (24) vjeç. Shih, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/PRISHTINË: VITI IV/Nr. 60/05 NËNTOR 2009, Ligji Nr. 03/L-145 PËR FUQIZIM DHE Pjesëmarrje të Rinisë, Neni 3.

rezidencial apo strehim familjar¹⁴⁰. Mirëpo, “hulumtimet e shkencave të ndryshme mbi njeriun, posaçërisht shkenca e psikologjisë dhe mjekësisë, kanë treguar se zhvillimi biopsikik dhe social i individit që nga fëmijëria, puberteti dhe adoleshenca, gjithëherë nuk përfundon me mbushjen e moshës tetëmbëdhjetëvjeçare, moshë kjo në të cilën konsiderohet se personi e arrin moshën madhore”¹⁴¹.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë që ka mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve, pothuajse të gjitha qeveritë e Kosovës kanë bërë përpjekje serioze në ngritjen e nivelit të një jete cilësore për të gjithë fëmijët e Kosovës, duke i konsideruar ata si një standard fundamental për shoqërinë demokratike dhe të zhvilluar. “Me qëllim të respektimit, avancimit dhe riafirmimit e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes, pa kurrfarë dallimi dhe përjashtimi, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe ofrimit të hapësirës për t’i shprehur lirisht bindjet dhe pikëpamjet e tyre, legjislacioni kosovar përmban dispozita të veçanta që garantojnë këtë të drejtë pa asnjë dallim”¹⁴².

Njëra ndër të drejtat bazë të fëmijëve por edhe çdo njeriu është e drejta e shkollimit, kjo e drejtë është ndër të drejtat bazë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës ku në Nenin 74 thotë, “secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj”¹⁴³. Po ashtu, në ligjin për arsimin potencohet se, “asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsimim”¹⁴⁴. Ndërsa, në Ligjin për Shëndetësi, sidomos për fëmijët krijohet një bazë e mirë dhe e garantuar ligjore për sa i përket kontrollimit të shëndetit të tyre, siç specifikohet

¹⁴⁰ Dr. Ian Milligan, UNICEF, Fuqizimi i kujdesit të bazuar në familje, fuqizimi i punës sociale. Një analizë e situatës së strehimit familjar në Kosovë (RKSOKB 1244), 2015, fq. 28.

¹⁴¹ Ismet Salihu, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta Penale për të Mitur, Prishtinë, 2005, fq. 89.

¹⁴² Republika e Kosovës, Qeveria-KOMITETIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËS GJENEVË, RAPORT MBI ZBATIMIN E KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, Prishtinë 2010, fq. 22.

¹⁴³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, E Drejta për Arsim, 15 qershor 2008, Neni 47.

¹⁴⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, Neni 3, Paragrafi 1,2.

“të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor”¹⁴⁵.

Shikuar në tërësi, respektimi dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve në aspektin ligjor qëndron mirë, madje pothuajse në përputhje të plotë me Konventat dhe standardet Evropiane dhe bashkëkohore. Por, problemi qëndron tek zbatimi i tyre në praktik, dhe jo çdo herë dhe çdo fëmijë arrin ti gëzojë këto të drejta të garantuara me Konventat ndërkombëtare dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

9.1 Format e mbrojtjes të fëmijëve

Administrimi i gjendjeve komplekse dhe delikate që kanë për objekt fëmijët nënkupton një marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi midis Komunave, të vetme ose të shoqëruara, Qendrave për Punë Sociale si Institucione për mbrojtjen e fëmijëve dhe Autoriteteve Gjyqësore, me Shkollat dhe Organizatat Shëndetësore¹⁴⁶ që mund të bashkëpunojnë me drejtësinë¹⁴⁷.

Mbrojtja e fëmijëve konsiderohet përgjegjësi institucionale, familjare dhe shoqërore, sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijës “nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë”¹⁴⁸. Ndërsa mbrojtësi i fëmijës në këtë rast viktimës, nëse fëmija konsiderohet se është viktimë e abuzimit apo keqtrajtimit “nënkupton personin zyrtar publik, i cili përfaqëson palën e dëmtuar në procedura gjyqësore dhe administrative, përfshirë edhe fëmijën”¹⁴⁹. Sipas Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare, përgjegjësia institucionale, profesionale dhe shoqërore, nënkupton përgjegjësin e secilit sipas pozitës që ka në mbrojtjen, parandalimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve. Sipas dispozitave ligjore çdo njëri i cili sipas pozitës së tij nuk merr mas parandaluese dhe konstatohet se si palë e tretë nuk e ka

¹⁴⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI, Neni 4, Paragrafi 2.

¹⁴⁶ Mbrojtja e fëmijëve kërkon marrjen e masave të karakterit legjislativ, administrative, social dhe edukativ. Shih, Ismet Elezi & Vasilika Hysi, Politika Kriminale, Tiranë, 2006, fq. 158.

¹⁴⁷ Amici Dei Bambini – Il Diritto Di Essere Figlio, Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë, fq. 10.

¹⁴⁸ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 14/17 KORRIK 2019, PRISHTINË, LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS, Neni 3, Paragrafi 1.7.

¹⁴⁹ Po aty, Neni 3, Paragrafi, 1.8.

raportuar rastin e abuzimit tek organet përgjegjëse, mund të dënohet sipas kodit penal të Kosovës¹⁵⁰.

Sipas Ligjit të Familjes “çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar, madje fëmijët me të meta mendore ose fizike gëzojnë të drejtë për kujdes të posaçëm, për një jetë të përshtatshme, në kushte të jetës që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën shoqërore. Po ashtu, çdo fëmijë gëzon të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi dhe abuzimi, nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin ose dëmton shëndetin e tyre, dhunimi seksual, përdorimi i drogave dhe fëmijët nuk duhet lejuar që të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve”¹⁵¹.

Në Ligjin për Familjen në Nenin 128 përgjegjësia prindërore nënkupton se fëmija është nën përgjegjësi prindërore deri në moshën madhore. “Prindërit kanë obligim të sigurojnë në çdo kohë të drejtat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë”¹⁵². Fëmija sipas dispozitave ligjore, “deri në moshën 7 vjeçare, lejohet të shfrytëzoj rrugën vetëm nën mbikëqyrjen e personit që është së paku i moshës 10 vjeçare dhe të bartë elemente retro-reflektuese me përjashtim brenda zonave të banuara”¹⁵³. Prandaj, fëmija normal deri në moshën madhore konsiderohet dëshmitar i jashtëzakonshëm. Fëmijët e kësaj moshe nuk ndikohen nga faktorët shoqëror ekonomik, sikur që ndikohen personat e rritur.

Në rastet kur fëmijët nuk e gëzojnë të drejtën e tyre prindërore nga prindërit e tyre biologjik, si pasojë e rrethanave jo adekuate që duhet t’u përgjigjet mirëqenies së fëmijëve, fëmija mund të mbetet pa kujdes prindëror. Sipas dispozitave ligjore si dhe konventave ndërkombëtare, “fëmijë

¹⁵⁰ GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË/PRISHTINË: VITI II/NR. 12/01 MAJ 2007, Ligji Nr. 02/L-17 PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE, Neni 10, Paragrafi 1.6.

¹⁵¹ GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË/PRISHTINË :VITI I/NR. 4/01 SHTATOR 2006, Ligji Nr. 2004/32, LIGJI PËR FAMILJEN I KOSOVËS, Neni 125.

¹⁵² Po aty, Neni 128.

¹⁵³ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/PRISHTINË: VITI III/Nr. 36/25 GUSHT 2008, LIGJI NR. 02/L-70 PËR SIGURINË NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR, Neni 142.

pa kujdes prindëror¹⁵⁴ konsiderohet fëmija prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilit janë të panjohur ose janë zhdukur; prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror¹⁵⁵. “Interesat më të mira të fëmijës zakonisht përmbushen kur nevojat e zhvillimit të tyre fizik dhe psikologjik plotësohen brenda kontekstit të familjes natyrore të tij. Vetëm në rrethanat kur ka arsye për të dyshuar se një fëmijë është duke pësuar dëm serioz në shëndetin e tij fizik ose mendor, ose është në rrezik për diçka të tillë brenda familjes së tij, mund të merret në konsideratë heqja e tij nga përkujdesja e prindit ose prindërve ose përkujdesësit tjetër të tij.”¹⁵⁶.

9.2 Të drejtat e personave me nevoja të veçanta

Personat me nevoja të veçanta, kuptohet si gjendje që duhet të adresohet ose një cenueshmeri që mund të përmirësohet nëpërmjet veprimeve bamirëse. Me miratimin e konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me aftësi të Kufizuara në vitin 2006, janë duke u bërë përpjekje që aftësitë e kufizuara të kuptohen përmes këndvështrimit të drejtave të njeriut ose modelit bio-psiko-social të personave me nevoja të veçanta¹⁵⁷. Sipas Konventës, “personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjate të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë”¹⁵⁸.

Përkufizimi i fëmijëve me nevoja dhe aftësi të kufizuara sipas ligjit për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë nënkupton, “fëmijën me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjatë të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë

¹⁵⁴ Format themelore për mbrojtjes e fëmijëve pa kujdesin prindëror janë: kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi.

¹⁵⁵ GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË/PRISHTINË :VITI I/NR. 4/01 SHTATOR 2006, Ligji Nr. 2004/32, LIGJI PËR FAMILJEN I KOSOVËS,, Neni 156.

¹⁵⁶ GAZETA ZYRTARE E INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË/PRISHTINË :VITI II/NR. 12/01 MAJ 2007, Ligji Nr. 02/L-17 PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE, Neni 10, Paragrafi 1.1, 1.3.

¹⁵⁷ Paula Frederica & Vjollca Belegu, UNICEF KOSOVA, Analiza e Situatës, Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë, 2017, fq. 33.

¹⁵⁸ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokolli Opsional, 2006, Neni, 2.

dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë”¹⁵⁹. Ndërsa, si formë e neglizhimit dhe në të njëjtën kohë mos arritjen e gëzimit të drejtave të tyre njerëzore, është edhe diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që bënë dallim, përjashtim apo kufizim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ndikon në mohimin e njohjes, gëzimit, njësoj si gjithë të tjerët, në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile dhe në fusha të tjera¹⁶⁰.

Në Strategjinë Nacionale të Kosovës për personat me nevoja të veçanta, ndër detyrimet që rrjedhin nga ky dokument kanë për fokus pesë fusha kryesore të jetës së qytetarëve me aftësi të kufizuara: shëndetësi, mirëqenie sociale dhe punësim, arsim, mbrojtje ligjore dhe qasje. Kjo strategji institucionale, ndër përparimet kryesore sa i përket personave me nevoja të veçanta e thekson, miratimin e Ligjit për Personat e Verbër, Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, si dhe ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në institucione publike për personat e shurdhër¹⁶¹. Mirëpo, në praktik sipas Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës, “personat me aftësi të kufizuara nuk marrin mbështetjen e duhur nga institucionet vendore, pagesat sociale janë shumë të vogla, mungojnë shërbimet elementare dhe mungon asistenti personal për fëmijët me nevoja të kufizuara. Shërbimet shëndetësore dhe sociale për personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme dhe ka shumë sfida në garantimin e qasjes fizike në institucionet publike”¹⁶².

Drejtori Ekzekutiv i HANDIKOS-it, z. Afrim Maliqi në një Intervistë për Koha.net, ndër problemet kyçe por jo vetëm me të cilat përballën personat me nevoja të veçanta konsideron, “Ligji për qasje apo infrastrukturën e personave me aftësi të kufizuar që nuk zbatohet fare, ligji për punësim për personat me aftësi të kufizuar ende nuk ka filluar të zbatohet, përfshirja e fëmijëve në edukim është jashtëzakonisht e vogël dhe është brengë tepër e madhe si për neve, si për institucionet tona. Personat me aftësi të kufizuara janë grupi më i varfër në vendin tonë, njëkohësisht edhe janë të diskriminuar, këtë e mbështesim edhe nga ligji i mbrojtjes nga

¹⁵⁹ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 14/17 KORRIK 2019, PRISHTINË, LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS, Neni 3, Paragrafi 1.2.

¹⁶⁰ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokolli Opsional, 2006, Neni, 3.

¹⁶¹ Republika e Kosovës, Qeveria, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, PLANI NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2018-2020, Prishtinë, 2018, fq. 7.

¹⁶² HANDIKOS, DASH: PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOSOVË TË DISKRIMINUAR, 15.04.2016.
<http://www.handi-kos.org/sq/Njoftime/DASH-PERSONAT-ME-AFTESI-TE-KUFIZUARA-NE-KOSOVE-TE-DISKRIMINUAR-249>, Vizituar më: .2.03.2020.

diskriminimi i cili thekson se nëse një person me aftësi të kufizuara nuk mund të marrë shërbime për shkak të qasjes, atëherë konsiderohet diskriminim”¹⁶³.

Nga studimi shohim se ekziston një diskrepancë e theksuar në mes të dhënave zyrtare nga Institucionet Qeveritare dhe atyre të Organizatave Joqeveritare. Në parim, legjislacioni vendore është në përputhje me Konventat Ndërkombëtare sa i përket kategorisë së personave me nevoja të veçanta, edhe pse akoma ka për tu bërë, mirëpo dallimi shihet në mes asaj që ndodhë në praktike si dhe pretendimeve qeveritare dhe atyre joqeveritare siç janë Organizatat që mision të tyre kanë personat me nevoja të veçanta. Sipas Institucioneve konsiderohet se është bërë përparim i dukshëm për këtë kategori, ndërsa sipas Organizatave Joqeveritare kjo kategori e njerëzve akoma përballën me gjërat elementare sa i përket realizimit të të drejtave të tyre njerëzore, në aspektin human, njerëzore dhe ligjore.

9.3 Të drejtat e Grave dhe Barazia Gjinore

Barazia gjinore nënkupton barazinë e plotë të meshkujve dhe femrave para ligjit, gëzojnë të drejtën e trajtimit të barabartë dhe barazisë së plotë në raport me organet shtetërore apo palët me ndikim në sektorin privat. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën 34/180 të datës 18 dhjetor 1979, hyrë në fuqi më 3 shtator 1981, në Nenin 1 shprehja "diskriminimi ndaj grave" nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasoj ose për qëllim të komprometoj ose të asgjësoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër”¹⁶⁴.

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është traktati më i përparuar ndërkombëtar. Konventa synon të sigurojë

¹⁶³ Koha.net, Maliqi: Personat me nevoja të veçanta më të diskriminuarit në Kosovë, 02.10.2019. <https://www.koha.net/arberi/197049/maliqi-personat-me-nevoja-te-vecanta-me-te-diskriminuarit-ne-kosove/>, Vizituar më: 02.02.2020.

¹⁶⁴ KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 34/180 të datës 18 dhjetor 1979, Hyrë në fuqi: me 3 shtator 1981, Neni 1.

tolerancë zero për këtë lloj dhune dhe është një hap i madh përpara për ta bërë Evropën më të sigurt. Konventa e njeh dhunën ndaj grave si shkelje të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi. Konventa kriminalizon vepra të tilla si: gjymtimin gjinor, martesën e detyruar, përndjekjen, abortin dhe sterilizimin e detyruar¹⁶⁵. Sipas Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, mbrojtësi i viktimave “këshillon, inicion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitoroj mbarëvajtjen e procesit gjyqësor”¹⁶⁶.

Sipas Konventës Shtetet duhet ti marrin këto masa në parandalimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave: Parandalimi, Mbrojtja, Ndjekja penale, Politika të integruara, etj. Dispozitat që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë janë paraparë me Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë për të Mituri dhe Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale¹⁶⁷.

Ligji për Barazi Gjinore i Republikës së Kosovës “garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë”¹⁶⁸, “siguron mundësi dhe trajtim të barabartë të femrave dhe meshkujve, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera. Barazia gjinore nënkupton ushtrimin e plotë dhe të barabartë, të femrave dhe meshkujve, sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut”¹⁶⁹, “si dhe mos diskriminimin gjinor”,¹⁷⁰ pavarësisht prejardhjes.

¹⁶⁵ COUANCIL OF EUROPE, KONVENTA E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE, Konventa e Stambollit. TË SIGURTË NGA FRIKA TË SIGURTË NGA DHUNA. <https://rm.coe.int/168064d3f6>, Vizituar më: 15.02.2020.

¹⁶⁶ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/PRISHTINË: VITI V/Nr. 76/10 GUSHT 2010, LIGJI Nr. 03/L-182 PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE, Neni 2, Paragrafi 1.8.

¹⁶⁷ OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, RAPORTIMI PËR DHUNËN NË FAMILJE, Nëntor, 2018, fq. 6.

¹⁶⁸ Mekanizmat Institucional të cilat janë përgjegjës për barazinë gjinore në Kosovë janë: Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, Njësitë e të Drejtave të Njeriut në çdo Ministri, Agjencia për Barazi Gjinore, Komisioni për të drejtat e njeriut, mundësi të barabarta, çështje gjinore dhe të zhdukurve pranë Kuvendit të Kosovës, Zyrtarët për Barazi Gjinore në secilën Ministri, Grupi Ndërmëtor për Barazi Gjinore, Njësitë për Barazi Gjinore në kuadër të Entit të Statistikave të Kosovës, Zyrtarët për Barazi Gjinore në të gjitha komunat e Kosovës.

¹⁶⁹ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 16/26 qershor 2015, PRISHTINË, LIGJI Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore i Republikës së Kosovës, Neni 3, Nën Paragrafi 1.1.

Për të ilustruar perceptimet që i kontribuojnë diskriminimit në baza gjinore kundër djemve dhe vajzave, 41 % e grave dhe burrave të anketuar kanë besuar se “djemtë duhet të kenë një disiplinë më të rreptë se sa vajzat për arsye se kjo i bënë ata të fortë”, derisa 47.2 % kanë thënë se, “vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë se sa djemtë në mënyrë që të jenë moralisht në rregull”. Një përqindje pak më e vogël e grave të anketuara kanë besuar se vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë¹⁷¹. Përgjegjësia për avancimin dhe integrimin gjinor parasheh se “të gjitha institucionet publike, në të gjitha nivelet e pushtetit janë përgjegjëse për përfshirjen e integritit gjinor në të gjitha politikatat, dokumentet dhe legjislacionin. Nga kjo përgjegjësi rrjedh edhe e drejta dhe detyrimi për përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej 50 % për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”¹⁷². Ligji për Barazi Gjinore nuk kërkon që në mënyrë arbitrare të bëhet dhe të plotësohet kuota për barazi gjinore, por të ndërmerren masa me qëllim realizimin e barazisë midis femrave dhe meshkujve. Po ashtu, ligji i obligon të gjitha institucionet qendrore dhe lokale të bëjnë planifikimin buxhetor sa i përket realizimit të të drejtave të barabarta dhe avancimin e tyre në shoqëri¹⁷³.

Sipas hulumtimit të realizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore, Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për hartimin e strategjisë së parë nacionale dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje në Kosovë, “përafërsisht 40 % e të anketuarve janë pajtuar se “dhuna është një pjesë normale e cilësdo marrëdhënie, dhe shoqëria në përgjithësi, e pranon faktin se herë pas herë dhuna ndodh.” Pothuajse 20 % e të anketuarve janë pajtuar se “ndonjëherë është në rregull që burri ta godas gruan e tij” dhe më shumë se një e treta kanë besuar se “është e natyrshme që dhuna

¹⁷⁰ Diskriminim gjinor konsiderohet “kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohej një person i gjinisë tjetër në një situatë të krahasueshme”. Shih, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 16/26 qershor 2015, PRISHTINË, LIGJI Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore i Republikës së Kosovës, Neni 3, Nën Paragrafi 1.5.

¹⁷¹ Agjencia për Barazi Gjinore, Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për hartimin e strategjisë së parë nacionale dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje, Prishtinë, 2008, fq. 20.

¹⁷² GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 16/26 qershor 2015, PRISHTINË, LIGJI Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore i Republikës së Kosovës, Neni 6, Paragrafi 8.

¹⁷³ Viktimat e dhunës në familje në Kosovë shpesh janë në mëshirë të një sistemi gjyqësor që dështon t’i mbrojë ato. Shih, BalkanInsight, Autor: Shqipe Gjocaj, Cikël i egër: Sindroma e Grave të Abuzuara në Kosovë, November 8, 2017, <https://balkaninsight.com/2017/11/08/cik%C3%AB-i-eg%C3%ABr-sindroma-e-grave-t%C3%AB-abuzuara-n%C3%AB-kosov%C3%AB-11-03-2017/?lang=sq>, Vizituar me: 02.03.2020

fizike ndodh nganjëherë kur një çift grindet. "Në mënyrë habitëse, dy të tretat e të anketuarve janë pajtuar se "marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë e dhunshme nëse ajo zhvillohet ndërmjet dy të rriturish të cilët janë të martuar." Shumica e të anketuarve ia atribuojnë sjelljen e dhunshme papunësisë 62.4 % ose alkoolit 43 %, dhe besojnë se dhuna ka qenë "normale" ose e pranueshme në rrethana të tilla"¹⁷⁴.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) ka publikuar një raport ku flet për paragjykimet ndaj grave në vendet që përbëjnë 80 % të popullsisë së botës. Nga ky raport, 90 % e njerëzve në botë i paragjykojnë gratë, 40 % e njerëzve në botë mendojnë se burrat janë drejtues më të mirë të biznesit, 50 % e njerëzve në botë mendojnë se burrat e kryejnë më mirë detyrën e udhëheqësit në politik, 28 % e njerëzve në botë e justifikojnë dhunën e një burri ndaj gruas së tij, 24 % e ulëseve në parlamente në të gjithë botën mbahen nga gratë, 10 gra udhëheqin me qeveritë nga 193 vende¹⁷⁵.

9.4 Të drejtat e punëtorëve dhe sindikatave

Çdo njerit i garantohet liria e zgjedhjes së profesionit dhe punës në kushte të barabarta në çdo vend pune apo profesion. Këtë e parasheh edhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut ku thotë se, "secili ka të drejtë të punoj, të zgjedhë lirisht punën, të ketë kushte të kënaqshme dhe të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia"¹⁷⁶. Nga ky parim shihet se asnjëri nuk guxon të diskriminohet dhe si pasojë të privohet nga e drejta e tij për vendin e punës, dhe nga mohimi i kësaj të drejte të privohet më pas nga e drejta për jetë dhe mirëqenie sociale.

Kosova sa i përket të drejtave të punëtorëve, "që nga pas lufta është përball me zhvillime të ndërlikuara politike, dhe si pasojë të drejtat socio-ekonomike dhe të drejtat e punëtorëve nuk janë adresuar siç duhet, as në kohën e UNMIKU-të, as të EULEX-it dhe as të pushtetit

¹⁷⁴ Agjencia për Barazi Gjinore, Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për hartimin e strategjisë së parë nacionale dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje, Prishtinë, 2008, fq. 2.

¹⁷⁵ Radio Evropa e Lirë, Lendi Susuri, Infografikë, 5 mars 2020. <https://www.evropaelire.org/a/30470541.html>, Vizituar më: 07.03.2020.

¹⁷⁶ DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948, Neni 23.

vendor”¹⁷⁷. Diskriminimi në punësim ndodh pothuajse në të gjithë sektorët, publik dhe privat. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës pranoi raporte prej sindikatave dhe individëve që pohonin shkelje dhe diskriminim në vendin e punës. “Sipas BSPK-së punësimi, veçanërisht në sektorin publik, varej nga statusi dhe përkatësia politike e punëtorit. Po ashtu, sindikatat raportojnë për keqtrajtime, ngacmimin seksual, diskriminimi i kandidatëve femra gjatë intervistave për punësim dhe përjashtimi në mënyrë të paligjshme i femrave për shkak të shtatzënisë ose për shkak se kërkonin pushim të lehonisë”¹⁷⁸.

Kur flitet për realizimin e të drejtave të punëtorëve, barazia dhe standardet në mes sektorit publik dhe privat nuk janë në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Punëtorët në sektorin privat, krahasuar me atë të sektorit publik nuk i gëzojnë në të shumtën e rasteve as të drejtat më elementare, për faktin se shumica e të punësuarve në sektorin privat janë pjesë e ekonomisë joformale, ekonomisë së zezë dhe janë të dëmtuar nga shmangiet e shpeshta fiskale¹⁷⁹. Sipas Raportit të Departamentit të Shtetit Amerikan, “burimet e Qeverisë, përfshirë masat mbrojtëse, nuk ishin të mjaftueshme për të siguruar zbatimin e ligjit, për t’i identifikuar dhe mbrojtur viktimat, dhe për t’i hetuar pohimet për punë të dhunshme apo të detyruar. Pati hetime, ndjekje penale apo dënime të kufizuara për punë të dhunshme sipas Inspektoratit të Punës, burimeve joadekuate. Dënimet, ndonëse ishin më të rrepta në krahasim me dënimet për krime të tjera të rënda, nuk mjaftonin për ta parandaluar punën e dhunshme”¹⁸⁰.

¹⁷⁷ Afrim Hoti, Respektimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Punëtorëve në Kosovë, Prishtinë, 2011, fq. 3. https://www.solidar.org/system/downloads/attachments/000/000/292/original/37_kosovo_labourlae_albanian.pdf?1457601322, Vizituar më: 15.02.2020.

¹⁷⁸ Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2018 Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, RAPORTI I VITIT 2018 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË. https://xk.usembassy.gov/ep-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2018_Alb.pdf, Vizituar më: 18.02.2020.

¹⁷⁹ Afrim Hoti, Respektimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Punëtorëve në Kosovë, Prishtinë, 2011, fq. 3. https://www.solidar.org/system/downloads/attachments/000/000/292/original/37_kosovo_labourlae_albanian.pdf?1457601322, Vizituar më: 15.02.2020.

¹⁸⁰ Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2018, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, RAPORTI I VITIT 2018 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË. https://xk.usembassy.gov/ep-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2018_Alb.pdf, Vizituar më: 18.02.2020.

9.5 Liria e tubimit dhe asociimit

Sa i përket llojeve të tubimeve publike janë të ndryshme si, protesta, demonstrata, fushata zgjedhore etj. Liria dhe e drejta e tubimit paqësor është e drejt e garantuar me Konventa, Kushtetutë dhe Ligj. “Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare ose mbrojtjen e të drejtave të tjerëve”¹⁸¹.

Në sistemet demokratike ku qeveriset në bazë të së drejtës ligjore, ekzistojnë kritere të përcaktuara për mënyrën, formën si dhe kohën e mbajtjes së tubimeve publike. “Në bazë të këtyre kritereve, kërkohet leja për mbajtjen e tubimeve publike, caktimi i vendit, kohëzgjatja, mbajtja e rendit dhe sigurimi i tubimit. Ekzistojnë raste kur tubimet publike ndalohen si p.sh., kur mbizotëron gjendje lufte dhe gjendje e jashtëzakonshme, cenim i rendit territorial dhe kushtetues, përdorimi i dhunës, prishja e rendit publik, nxitja e urrejtjes racore, ndëretnik ose fetare. Në bazë të dispozitave ligjore nuk mund të vihet kufizim ose ndalim, përveç kur një kufizimi i tillë imponohet për ruajtjen e sigurisë, shëndetit dhe sigurisë publike në përputhje të plotë me dispozitat ligjore”¹⁸². “Çdo njëri ka të drejtë të themelojë organizatë, të jetë apo të mos jetë anëtar i një organizate, si dhe të marrë pjesë në aktivitetet e një organizate”¹⁸³. “Aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente”¹⁸⁴.

9.6 E drejta pronësore

Çdo njërit i garantohet e drejta pronësore dhe shfrytëzimi i sajë të cilën e ka përvetësuar në përputhje të plotë me dispozitat ligjore, nga kontributi dhe puna e tij pa ndërhyrjen e pavend të

¹⁸¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Liria e Tubimit, 15 qershor 2008, Neni, 43.

¹⁸² Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 127.

¹⁸³ “Çdokush ka të drejtën e tubimit paqësor dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën e themelimit të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to”. Shih, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 11.

¹⁸⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Liria e Asociimit, 15 qershor 2008, Neni 44.

shtetit. Secilit njëri në kushte të barabarta i garantohet mundësia për zhvillim ekonomik e cila ofrohet nga ekonomia e lirë e tregut. Personat e huaj juridik dhe fizik gjithashtu kanë të drejtë të fitojnë pronësi të paluajtshme në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare. Personat e huaj kanë të drejtën e koncesionit mbi pasurit natyrore si dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj¹⁸⁵.

Sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, “çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar me ligj dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit, moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”¹⁸⁶.

Nga e drejta pronësore nuk mund të privohet askush në mënyrë arbitrare, për faktin se e drejta pronësore konsiderohet e shenjët, e paprekshme, e pacenueshme dhe e garantuar për çdo njeri. E drejta pronësore sa i përket garantimit në aspektin ligjor vendor dhe ndërkombëtar, konsiderohet e garantuar, madje, ligjet e Kosovës janë të avancuara sa i përket barazisë gjinore dhe gëzimin e të drejtave të tyre pronësore. Problemi qëndron të zbatimi i tyre në praktik, sa nga mos njohurit e qytetarëve, sa nga ndikimi permanent i ndikimit familjar dhe traditës. Nga ky këndvështrim, shumë vajza me vetë dëshirë heqin dorë nga e drejta e tyre pronësore, por pa përjashtuar rastet kur disa nga to e kërkojnë këtë të drejtë, disa nga to arrijnë të realizojnë në praktik e disa të tjera janë përballur me diskriminim si dhe me shkëputje edhe të lidhjeve familjare.

9.7 Të drejtat e pakicave

Një populli i cili i përket një pakice të caktuar, nënkupton bashkësinë etnike të cilët i bashkon origjina e përbashkët etnike, fetare, gjuhësore ose edhe cilësi të tjera të cilat i bëjnë të dallohen

¹⁸⁵ Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e kushtetutës), Prishtinë, 2007, fq. 128.

¹⁸⁶ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 8.

nga popullsia tjetër, të cilët dëshirojnë t'i ruajnë veçorit e tyre etnike, fetare dhe gjuhësore¹⁸⁷. Deklarata për të Drejtat e Personave Pjesëtarë të Pakicave Etnike, Fetare dhe Gjuhësore në Nenin 1 përcakton obligimet dhe detyrat që kanë shtetet në relacion me pakicat kombëtare. "Shtetet do të mbrojnë ekzistencën dhe identitetin kombëtar apo etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësore të pakicave brenda territoreve të tyre dhe do të përmirësojnë kushtet për avancimin e atij identiteti. Shtetet do të miratojnë masa adekuate ligjore dhe masat e tjera për të arritur qëllimet në fjalë"¹⁸⁸.

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencionit të Statistikave të Kosovës të vitit 2014, numri i popullsisë që jetojnë në Kosovës është 1.815.606 banorë. Shqiptarët përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë me rreth 92 %, komuniteti serb përbën rreth 3.5 %, dhe komunitetet e tjera etnike përbëjnë rreth 3.5 %¹⁸⁹. Kushtetuta e Kosovës përcakton Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare si dhe Raportin Shpjegues si të obligueshme në aspektin kushtetues dhe ligjorë. Kushtetuta përcakton "mekanizmat kyç për të siguruar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë. Legjislacioni i veçantë që lidhet me aspektet e rëndësishme të të drejtave të komunitetit po ashtu përfshinë çështjet tematike si përdorimi i gjuhëve, arsimimi dhe anti-diskriminimi"¹⁹⁰. "Legjislacioni në Kosovë garanton barazi në mes të të gjitha grupeve etnike minoritare që jetojnë në Kosovë, si dhe promovon të drejtat individuale të njeriut, përfshirë ato që i dedikohen personelit të uniformuar apo atij civil"¹⁹¹.

Në kohën moderne kur shumica e shteteve kanë avancuar dukshëm të drejtat dhe lirit e njeriut në përgjithësi, po ashtu edhe për pakicat etnike, kërkohet që shtetet të respektojnë identitetin e çdo pjesëtari që i përket një komuniteti tjetër pakicë, në të njëjtën kohë është obligim i shteteve që të krijojnë kushte të nevojshme për pakicat, për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar

¹⁸⁷ Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Shkup, 2007, fq. 435.

¹⁸⁸ DEKLARATA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE PJESËTARË TË PAKICAVE ETNIKE, FETARE DHE GJUHËSORE, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 18 dhjetor 1992, me rezolutën nr. 47/135, Neni 1.

¹⁸⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vlerësim Popullsisë e Kosovës 2013, shtator 2014.

¹⁹⁰ STEFANO GNOCCHI, PËRFAQËSUESI SPECIAL I BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË, TË ANGAZHOHEMI MË FUQISHËM, PËR KOMUNITETET E ROMËVE, ASHKALINJVE DHE EGJIPTIANËVE NË KOSOVË, PRISHTINË, 2013.

¹⁹¹ Donika Emini, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Përfshirje apo përjashtim? Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pas-pavarësisë, Prishtinë, 2014, fq. 9.

identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetarë¹⁹². “Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve”¹⁹³.

Të drejtat e komuniteteve jo çdo herë dhe në çdo kohë kanë qenë në nivelin e garantimit dhe respektimit. “Sipas raportit të Amnesty International komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian¹⁹⁴ akoma vazhdojnë të përjetojnë diskriminim duke përfshirë qasjen në arsim, kujdesin shëndetësor dhe në punësim. Për dallim nga këto ky komunitet ka gëzuar të drejtën në strehim adekuat. Duke u bazuar në raportet e OSBE-së, institucionet e Kosovës nuk i përmbushin angazhimet e tyre për krijimin e kushteve të përshtatshme për integrimin e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptianë”¹⁹⁵. “Ndonëse politikat arsimore ofrojnë mundësi të rëndësishme për promovimin e tolerancës ndëretnike dhe ndërtim të marrëdhënieve, ky sektor mbetet i ndarë dhe problematik në Kosovë, politika që theksojnë shumë gjuhësinë dhe kontaktimin e rregullt dhe pozitiv, si dhe respektimin e të drejtave të komuniteteve janë jetike”¹⁹⁶.

Kushtet e jetesës për strehimin e personave të zhvendosur që jetojnë në qendra kolektive për 20 vjet në Kosovë, në pjesët e banuara kryesisht nga pjesëtarë të komunitetit serbë, problemi ende nuk është zgjidhur plotësisht. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë (OSBE), në raportin e vet për “Vlerësimin e kthimit vullnetar në Kosovë”, incidentet që evidentohen më së shpeshti janë vjedhjet, sulmet verbale, por edhe fizike, zjarrvëniet, dëmtimi i trashëgimisë

¹⁹² Sevdie Kadriu, Universiteti Evropian i Tiranës, Përfaqësimi i Komuniteteve në Institucionet e Kosovës, Tiranë, 2016, fq. 27.

¹⁹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli III, Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, Parimet e Përgjithshme, 15 qershor 2008, Neni 57.

¹⁹⁴ “Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian vuan nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik”. Shih, Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2018, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, RAPORTI I VITIT 2018 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË.

https://xk.usembassy.gov/ep-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2018_Alb.pdf, Vizituar më: 18.02.2020.

¹⁹⁵ AMNESTY INTERNATIONAL, REPORT 2012, THE STATE OF THE WORLD'S HUMAN RIGHTS, fq. 295.

http://files.amnesty.org/air12/air_2012_full_en.pdf Vizituar më: 13.02.2020.

¹⁹⁶ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, MISIONI NË KOSOVË, Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve, Botimi i katërt, Nëntor 2015, fq. 9.

fetare lokale, bllokimi i vizitave për pelegrinët, si dhe kundërshtimet e hapura dhe protestat kundër kthimit të personave të zhvendosur. Kur bëhet fjalë për veprat penale të nxitjes së urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, trazira dhe jotolerancë, në përputhje me nenin 147 të Kodit Penal të vjetër, si dhe veprën penale të shkaktimit të përçarjes dhe jotolerancës, sipas nenit 141 të Kodit Penal të ri, nga data 01.01.2019 deri më 15.12.2019, Policia e Kosovës i regjistroi dhe hetoi vetëm 10 raste¹⁹⁷.

Në një sondazh publik të realizuar nga OSBE, 67 % e respondentëve joshqiptarë deklaruan se mosbesimi ndaj institucioneve gjyqësore të Kosovës përbënte pengesë serioze që ata t'i realizojnë të drejtat e tyre. 42 % të respondentëve joshqiptarë të cilët kishin pasur çështje në gjykatë gjatë dy viteve të fundit nuk kishin ndërmarrë asgjë për këto çështje, krahasuar me 19 % të respondentëve shqiptarë të Kosovës. Monitorimi i realizuar nga OSBE-ja ka shpalosur mangësi të mëdha në procedimin e krimeve të mundshme të urrejtjes. Këto raste rrallëherë shkojnë në gjykatë dhe shpesh ngelin diku mes policisë dhe prokurorisë, duke u cilësuar si vepra me "kryerës të panjohur", dhe as policia e as prokuroria nuk i çojnë deri në fund hetimet për t'i identifikuar kryerësit. OSBE ka monitoruar 27 raste ku kishte arsye të forta për të besuar se përbënin vepra penale të urrejtjes. Asnjëri rast nuk ishte dërguar ende në gjykatë, ndërsa kryerësit e mundshëm u identifikuan në vetëm tre raste, e 24 tjera duket të jenë endur sa andej këtej në Policinë e Kosovës dhe Prokurori me kërkesa për më shumë informata në mënyrë që të mund të ecej përpara¹⁹⁸.

Të drejtat e pakicave në Kosovë në aspektin kushtetues dhe ligjor janë garantuar, edhe pse dallimi i të drejtave në mes vetë pakicave konsiderohet i madhë për faktin se, pakica serbe gëzon disa të drejta të cilat minoritetet e tjera nuk i gëzojnë. Kjo ka ndodhur si pasojë e ndikimeve politike si dhe garantimi i këtyre të drejtave me Planin e Ahtisarit. Ky dallim i cili ekziston në mes minoriteteve ka bërë që edhe ndikimi i pakices serbe në institucionet e Kosovës të jetë shumë i madh. Pakicat i gëzojnë vendet e rezervuara në Kuvendin e Kosovës, madje duke filluar nga Kushtetuta dhe Ligjet që ndëlidhen në mënyrë të drejtëpërdrejte me Pakicat, nuk mund të miratohen, amandamentohen apo edhe të ndryshohen pa miratimin e dy

¹⁹⁷ Republika e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti Vjetor 2019, Nr. 19, Prishtinë, 2020, fq. 86, 87.

¹⁹⁸ OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË, Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve Botimi i katërt, Nëntor 2015, fq. 13,14.

të tretave të pakicave, më konkretisht pakices serbe. Shikuar në tersi, pakicat etnike gezojnë tretman të veçantë në Kosovë, penges mbetet mos integrimi i minoriteti serbe në shoqërin kosovare si pasojë e ndërhyrjes së drejtëpërdrejtë të Beogradit zyrtarë.

KAPITULLI I KATËRT

Roli i Organizatave Jo-Qeveritare dhe Mbrojtja Ligjore e të Drejtave të Njeriut në Kosovë

10. Roli i Organizatave Jo-qeveritare Ndërkombëtare dhe Vendore

Në një shtet ndërtimi dhe konsolidimi i demokracisë funksionale ku respektohen të drejtat e njeriut, kërkon pashmangshëm ekzistimin e shoqërisë civile apo siç njihen edhe si organizata joqeveritare. Këto organizata në parim janë dhe duhet të jenë të pavarura dhe të paanshme në mënyrë që të luajnë rolin informues dhe avokues sa i përket të drejtave të njeriut¹⁹⁹. Sipas Organizatës Amnesty International sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë, shprehet shqetësimi për mungesën e përmendjes të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në marrëveshje në mes Kosovës dhe Serbisë. Sipas kësaj Organizate, “nuk ka asnjë pikë në marrëveshje që të përfshijë të drejtat e njeriut, apo të përfshijë disa pika kryesore të cilat gjithmonë kanë qenë dhe duhet të jenë në vëmendjen e Serbisë dhe Kosovës”²⁰⁰. Duke u nisur nga ky fakt, Amnesty International u “kërkon përsëri këtyre autoriteteve dhe komunitetit evropian t’i thërrasë këto autoritete përsëri në tryezë dhe të bisedojnë këtë plan veprimi, por të marrin parasysh pikat kyçe për respektimin e të drejtave të njeriut. Nuk mund të kemi një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë dhe të flasim vetëm për një kufi”²⁰¹.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë-OSBE, ka pasur një rol aktiv në Kosovë si para luftës, gjatë luftës si dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë. Misioni i OSBE-së në Kosovë kryesisht mbështet në “mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, madje ky është njëri ndër prioritetet kryesore të saj. Për këtë arsye, OSBE punon me institucionet e Kosovës, përfshirë agjencitë për zbatim të ligjit, për të promovuar standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe parimet e sundimit të ligjit. Misioni i kushton vëmendje të veçantë të drejtave të komuniteteve, përfshirë këtu kthimin e pronës, kthimin dhe riintegrimin, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, si dhe qasjen në shërbime publike dhe përdorimin e

¹⁹⁹ Ali Musliu, Të drejtat e njeriut, Shkup, 2018, fq. 90.

²⁰⁰ Jezerca Tigani - Amnesty International

<https://www.zeriamerikes.com/a/raporti-amnesty-international/1666461.html>, Vizituar më: 19.01.2020.

²⁰¹ Jezerca Tigani - Amnesty International

<https://www.zeriamerikes.com/a/raporti-amnesty-international/1666461.html>, Vizituar më: 19.01.2020.

gjuhëve zyrtare”²⁰². Gjithashtu misioni i OSBE-së “ndihmon në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, parandalimin e dhunës në familje, përmirësimin e mbrojtjes dhe riintegrimin e viktimave përmes rritjes së bashkëpunimit në mes të gjithë akterëve relevant, përfshirë ministritë përkatëse, policinë, mbrojtësit e viktimave dhe përgjegjësit e strehimoreve”²⁰³.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë, “vlerëson se në Kosovë akoma nuk është krijuar një ambient i përshtatshëm për të shënuar përparim në realizimin e të drejtave të njeriut. Kosova, me një përqindje të madhe të varfërisë dhe papunësisë, me mungesë të programeve zhvillimore, me kufizim të lirisë së lëvizjes për shkak të vizave, akoma nuk mund të flitet për përparimin e shpejtë të të drejtave të njeriut”²⁰⁴. Ndërsa Organizata për Demokraci Antikorrupsion dhe Dinjitet “Çohu”, vlerëson se në Kosovë, “më shumë se shkelje të drejtpërdrejta të të drejtave individuale, ka shkelje të të drejtave sociale dhe grupore të njerëzve. Kjo për faktin se të gjitha politikat sidomos në fushën e ekonomisë, deri më sot kanë injoruar problemin kryesor që e ka Kosova, problemin e varfërisë. Diskriminimet më të mëdha të njerëzve sipas kësaj organizate kanë ndodhur në sektorin publik”²⁰⁵.

Shqetësimet tjera të të drejtave të njeriut përfshinin, “keqtrajtimin e raportuar të të ndaluarve nga policia, kushtet fizike nën standarde në burgje, abuzimin me lëndë narkotike, korrupsionin dhe favorizimin në burgje, paraburgimin e gjatë dhe jo efikasitetin e gjyqësorit që përfundon në përmbyllje të rasteve pa gjykim, si dhe kërkesat e pazgjidhura për rikthim të pronës prej luftës së viteve 1998-1999”²⁰⁶. “Problemet tjera të të drejtave të njeriut përfshinin dhunën në familje dhe diskriminimin ndaj grave, përzgjedhjen e seksit mbi baza gjinore, abuzimin e fëmijëve, trafikimin e personave, diskriminimin kundër pakicave, veçanërisht pakicës rome, mbështetjen

²⁰² Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë-OSBE, Misioni i OSBE-së në Kosovë Fakte për misionin, 2013. <https://www.osce.org/sq/kosovo/76510?doenload=true>, Vizituar më: 05.03.2020.

²⁰³ Po aty.

²⁰⁴ Fitore Fejza, Qendra për Arsim, KIPRED, Të Drejtat e Njeriut në Kosovë, 17.08.2013.

[http://www.kipred.org/repository/docs/T%C3%AB drejtat e njeriut n%C3%AB Kosov%C3%AB 30299.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/T%C3%AB%20drejtat%20e%20njeriut%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB%2030299.pdf),

Vizituar më: 19.01.2020.

²⁰⁵ Po aty.

²⁰⁶ RAPORTI I VITIT 2015 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË, PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE, fq. 1.

https://photos.state.gov/libraries/kosovo/312585/2016/HRreport2015_alb.pdf, Vizituar më: 19.01.2020.

joadekuate për personat me aftësi të kufizuar, kushtet e dobëta në objektet e shëndetit mendor, tensionet e herëpashershme etnike dhe puna e fëmijëve në sektorin joformal”²⁰⁷.

Sipas Behxhet Shalës, Drejtor Ekzekutiv i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë, “organizatat joqeveritare nuk i kanë përmbushur misionet e veta, me përjashtim të disa prej tyre, sepse janë derdhur shumë fonde, ndërsa nuk ka ndonjë ndryshim të gjendjes, ndonjë përshpejtim të proceseve demokratike, dhe nuk ka ndonjë ndikim në ndryshimin e punës së Qeverisë dhe institucioneve përgjegjëse për gjendjen që kemi sot. Një numër i vogël prej tyre ka përmbushur misionin, ndërsa pjesa tjetër ka ekzistuar dhe ekziston vetëm për të mbledhur fonde dhe për të shpenzuar para, e për të cilat asnjëherë nuk ka siguruar mbulesë”²⁰⁸.

Ndërsa sipas Driton Selmanaj tani Deputet i Parlamentit së Kosovës, roli i Organizatave Joqeveritare në Kosovë dhe bashkëpunimi me institucionet ndërqeveritare “ka ardhur si rezultat i moskomunikimit të sinqertë ndërmjet këtyre dy palëve. Do të thotë institucionet tona, partitë politike i shohin me shumë rezerva, paragjykime, më tepër duke tentuar t’i njollosin se dikush i ka themeluar ato, dikush qëndron prapa tyre”²⁰⁹.

Kurse Fidan Kalaja nga Lëvizja “Fol” thekson se, “sektori joqeveritar ka arritur të bëjë ndryshime, por jo në nivelin e duhur. Ky sektor e ka të vështirë realizimin e misionit të tij, për shkak se në disa raste konsiderohet si “armiqësor” karshi institucioneve qeverisëse. Kjo ka të bëjë me një lloji konflikti politik, arsyeim politik se institucionet qeverisëse e konsiderojnë shoqërinë civile si të panevojshme, në kuptimin se ata nuk dëshirojnë që të kenë një shtresë apo kategori të grupeve të njerëzve që kritikojnë apo monitorojnë punën e tyre”²¹⁰. Pa dyshim se roli dhe puna e Organizatave Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare mbetet i pa mohueshëm, edhe pse ka pasur, ka dhe do të ketë divergjenca sa i përket asaj se kush dhe cili është roli i secilit në shoqërinë kosovare.

²⁰⁷ Po aty, fq. 1.

²⁰⁸ Nadie Ahmeti, Radio Evropa e Lirë, Ç’interes përfaqësojnë OJQ-të në Kosovë? 05 Maj 2013. <https://www.evropaelire.org/a/24976995.html>, Vizituar më: 06.03.2020.

²⁰⁹ Po aty.

²¹⁰ Po aty.

10.1 Roli i gjyqësorit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Sipas Kushtetutës së Kosovës, pushtetet janë të ndara dhe si të tilla parashihet të krijojnë një balancë të kontrollit por edhe llogaridhënies. Shteti përmes sistemit të vet të drejtësisë ushtron veprimtarin e vet nëpërmjet organeve të tij, të cilave me Kushtetutë dhe Ligj u janë dhënë funksione të caktuara, të zgjidhin çështje e mosmarrëveshje që kanë lidhje me këto funksione. Rrethi i çështjeve që kanë të drejtë në bazë të ligjit të shqyrtojnë dhe të zgjidhin organet e një sistemi, quhet juridiksion²¹¹. “Nevojat kulturore të njeriut bashkëkohor kërkojnë sistem të atillë gjyqësor, i cili qytetarëve dhe shoqërisë do t’u siguronte jo vetëm drejtësinë, por edhe drejtësi me kohë”²¹². Sistemi gjyqësor bënë pjesë në mesin e tri pushteteve të ndara dhe të pavarura, Legjislativ, Ekzekutiv dhe Gjyqësor. Pushteti gjyqësor “ushrohet nga gjykatat, është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”²¹³.

“Gjykatësit gjatë ushtrimit të Profesionit në Gjykata, gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit si dhe gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Pas vendimeve gjyqësore garantohet e drejta për ankesë, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj”²¹⁴. “Gjykata në punën e saj është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit, si dhe merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor”²¹⁵. Qasja në drejtësi i ofrohet dhe i garantohet të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës sipas legjislacionit të saj në fuqi. “Sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdimisht ka qenë subjekt i kritikave për mos transparencë dhe llogaridhënie publike, përkundër faktit se akterët brenda sistemit të drejtësisë vazhdimisht proklamoni se puna e tyre bazohet në këto parime. Sipas IKD-së gjatë procesit të monitorimit sistematik të seancave gjyqësore në fushën penale, ka evidentuar raste

²¹¹ Jani Vasili, *Procedura Civile*, Tiranë, 2010, fq. 31.

²¹² Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli, *E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë*, Universiteti i Evropës Juglindore, Shkup, 2017, fq. 6.

²¹³ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 22/18 DHJETOR 2018, PRISHTINË, LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR GJYKATAT, Neni 3.

²¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Sistemi i Drejtësisë, Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor, 15 qershor 2008, Neni 102.

²¹⁵ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 37/28 DHJETOR 2012, PRISHTINË, KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE, Neni 8.

të mbylljes së kundërligjshme dhe arbitrare të seancave të caktuara gjyqësore, informimi për të cilat është i rëndësishëm për publikun, mediat dhe shoqërinë civile”²¹⁶.

Sipas Komisionit Evropian, ndarja e drejtësisë ishte e ngadalshme dhe dhënia e llogarisë nga ana e zyrtarëve të gjyqësorit ishte e pamjaftueshme. “Strukturat e gjyqësorit kishin ndërhyrje politike, me emërimet të kontestuara dhe mandate të paqarta. Ishin 395.274 raste civile e penale që pritnin të gjykoreshin. Mbi 118.000 masa të shqiptuara me vendime gjyqësore pritnin të ekzekutoheshin dhe më shumë se 186.365 padi për kundërvajtje pritnin të gjykoreshin”²¹⁷. “ Sipas Komisionit Evropian, ndarja e drejtësisë ishte e ngadalshme dhe dhënia e llogarisë nga ana e zyrtarëve të gjyqësorit ishte e pamjaftueshme. Strukturat e gjyqësorit prireshin të kishin ndërhyrje politike, me emërimet të kontestuara dhe mandate të paqarta”²¹⁸. “Strukturat përkatëse për mbrojtjen e viktimave dhe integritit në gjyqësor, janë transferuar te institucionet relevante, si Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor. Qëllimi i tyre është ofrimi i të gjitha parakushteve për gjykim të drejtë dhe qasje në drejtësi, duke marrë parasysh fushëveprimin dhe kompetencat e KPK dhe KGJK-së”²¹⁹.

Sa i përket punës, efikasitetit si dhe rolit të Gjykatave nga Organizatat e Shoqërisë Civile rekomandohet që të bëhet, “trajnimi i gjyqtarëve dhe prokuroreve për hetimin dhe gjykimin e torturës dhe keqtrajtimit, përkatësisht trajnimet e fokusuara në obligimet ligjore për hetimin dhe gjykimin e tyre, ofrimin e rasteve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për prokurorët dhe gjyqtarët në gjuhët lokale, avokimi që praktika e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të zbatohet nga gjykatat vendore, përkatësisht gjykatat

²¹⁶ Instituti i Kosovës për Drejtësi, MBYLLJA E KUNDËRLIGJSHME DHE ARBITRARE E SEANCAVE GJYQËSORE PËR PUBLIKUN NË ÇËSHTJET PENALE, Analizë e legjislacionit dhe praktikës së GjEDNj rreth natyrës publike të seancave gjyqësore dhe praktikës së mbrapshtë të krijuar nga Sistemi i Drejtësisë në Kosovë, Prishtinë, 2019, fq. 4.

²¹⁷ Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2015, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, RAPORTI I VITIT 2015 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË. https://photos.state.gov/libraries/kosovo/312585/2016/HRreport2015_alb.pdf, Vizituar më: 10. 02. 2020.

²¹⁸ RAPORTI I VITIT 2015 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË, PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE, fq. 10. https://photos.state.gov/libraries/kosovo/312585/2016/HRreport2015_alb.pdf, Vizituar më: 19.01.2020.

²¹⁹ Task Forca për Integrim Evropian, DOKUMENT DISKUTIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJEN E MINORITETEVE, fq. 9. http://www.mei-ks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Te_Drejtat_e_Njeriut.pdf, Vizituar më: 10.02.2020.

vendore të interpretojnë shkeljet e të drejtave të njeriut sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”²²⁰.

10.2 E Drejta e respektimit të jetës private dhe familjare

Sa i përket koncepteve për jetën private dhe familjare janë të shumta dhe të ndryshme, por e rëndësishme është se të gjitha këto koncepte kanë një pikë të përbashkët, atë të respektimit, garantimin dhe mbrojtjen e jetës private dhe familjare²²¹. “Jeta private përbën një koncept të gjerë i cili nuk mund të ketë një përcaktim të saktë. Megjithatë, koncepti është qartësisht më i gjerë se e drejta për jetë private dhe përfshin një sferë brenda të cilës çdokush mund të ndjekë lirshëm zhvillimin dhe plotësimin e personalitetit të tij/saj”²²². “Ruajtja e privatësisë apo të drejtës për jetë private përbën sot një nga të drejtat më të ndjeshme, për të cilën flitet shumë në nivel ndërkombëtar dhe kombëtarë. Respektimi i kësaj të drejte është domosdoshmëri për të pasur një jetë private, familjare dhe sociale”²²³.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në nenin 8 përcakton qartë mbrojtjen shtetërore të jetës private dhe familjare, po ashtu gëzimin e kësaj të drejte nga çdo qytetarë pavarësisht prejardhjes së tij/saj. Konventa përcakton se, “çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar me ligj, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose

²²⁰ Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës-QKRMT. TË DREJTAT E NJERIUT NË INSTITUCIONET KORREKTUESE NË KOSOVË, RAPORTI MONITORUES 2018, Prishtinë, 2019, fq. 54.

²²¹ Në shoqëritë demokratike, mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut në përgjithësi, po ashtu, mbrojtja e të dhënave personale konsiderohet detyrë dhe obligim për të gjitha institucionet dhe organet shtetërore. Shih, Përmbledhje ligjore e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Tiranë, 2013, fq. 3.

https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/permbledhese_ligjore_e_perditesuar_2013_563_1.pdf,

Vizituar me: 02.03.2020.

²²² Ursula Kilkelly, E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, Një udhëzues për zbatimin e Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Manuali e të drejtave të njeriut, Nr. 1, Këshilli i Evropës, 2001, fq. 11.

²²³ Aferdita Deda & Lirime Çukaj, E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Shteti juridik dhe demokracia”, Tetovë, 2014.

https://www.academia.edu/37916691/E_drejta_p%C3%ABr_respektimin_e_jet%C3%ABs_private_dhe_familjare,

Vizituar më: 26.02.2020.

moralit, si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”²²⁴. “Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj”²²⁵.

10.3 E drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm

Barazia para ligjit dhe e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm është e drejtë e garantuar me Konventat Ndërkombëtare, me Kushtetutën e Kosovës si dhe me Ligjet në fuqi. “Me dispozitat e të Drejtës Penale në kuptimin e ngushtë është përcaktuar qëndrimi parimor i shtetit lidhur me atë se si duhet vepruar kur në rastin konkret është kryer vepra penale”²²⁶. “Rëndësia e respektimit të të drejtave të njeriut në vendet e privimit të lirisë merr një karakter më specifik duke qenë se të drejtat e personave në këto vende sikurse edhe çdo aspekt tjetër që zhvillohet përbrenda jetës institucionale varet tërësisht nga autoritetet, politikat dhe personat që punojnë aty nën petkun e autoritetit publik përgjegjës”²²⁷.

Parimet e procedurës penale marrë në përgjithësi, përfaqësojnë rregullat mbi të cilat mbështete procedura penale dhe institucionet e veçanta procedural që kanë të bëjnë me të. Procedura penale bazohet në një mori parimesh, disa prej këtyre parimeve i përkasin rregullimit të sistemit juridik në përgjithësi dhe si të tilla, konsiderohen parime kushtetuese, kurse të tjerat janë thjesht parime procedural²²⁸. “Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës”²²⁹. “Askush nuk mund të dënohet për vepër, e cila para se të kryhet nuk ka qenë e paraparë me ligj apo me dispozitë tjetër si vepër penale dhe për të cilën nuk është paraparë denimi”²³⁰. Po ashtu, “askush nuk mund t’i nënshtrohet gjykimit për vepër penale për të cilën

²²⁴ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Romë 04.11.1950, Hyrë në fuqi më 03.09.1953, Neni 8.

²²⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, E Drejta e Privatësisë, 15 qershor 2008, Neni 36.

²²⁶ Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Shkup, 2017, fq. 3.

²²⁷ Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës-QKRMT. TË DREJTAT E NJERIUT NË INSTITUCIONET KORREKTUESE NË KOSOVË, RAPORTI MONITORUES 2018, Prishtinë, 2019, fq. 16.

²²⁸ Azem Hajdari, E Drejta e Procedurës Penale e të Miturve (Me Ligjin Penal për të Mitur), Prishtinë, 2005, fq. 35.

²²⁹ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 37/28 DHJETOR 2012, PRISHTINË, KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE, Neni 3.

²³⁰ Vllado Kambovski & Ismail Zejneli, E Drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2018, fq. 38.

më parë është liruar ose është dënuar me vendim të formës së prerë në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të një shteti”²³¹.

Sipas Deklaratës së Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut prezumimi i pafajësisë nënkupton se, “çdonjëri që akuzohet për vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm përderisa të mos provohet në bazë të ligjit faji”²³². Kushtetuta parasheh se të gjithë njerëzit pa dallim janë të barabartë para ligjit. Secili njeri gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore²³³. Por, mbrojtja e barabartë ligjore nuk parandalon vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato²³⁴. Sipas Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, “Agjencia për Ndhimë Juridike Falas, një agjenci e pavarur qeveritare me mandat për të ofruar ndihmë juridike falas personave me të ardhura të ulëta, nuk ka funksionuar siç ishte paraparë, duke ofruar vetëm këshilla ligjore, pa i përfaqësuar rastet në gjykatë”²³⁵.

Secilit njeri i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, ka të drejtë për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se është në të mirë të drejtësisë përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në pajtim me ligjin²³⁶.

²³¹ Ejup Sahiti, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2005, fq. 37.

²³² DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948.

²³³ Çdo person konsiderohet i barabartë para gjykatave dhe organeve gjyqësore dhe çdonjëri ka të drejtë në barazi të plotë në garantitë minimale për gjykim të drejtë. Shih, Wolfgang Benedek and Minna Nikolova, KUPTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DORACAK MBI ARSIMIMIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT, Austri 2003, fq. 228.

http://www.manual.etcgraz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETCHauptseite/manual/versionen/albanian/Manual_vollversion_albanisch.pdf, Vizituar më: 19.02.2020.

²³⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Barazia para Ligjit, 15 qershor 2008, Neni 24.

²³⁵ RAPORTI I VITIT 2015 MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË, PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE, fq. 11.

https://photos.state.gov/libraries/kosovo/312585/2016/HRreport2015_alb.pdf, Vizituar më: 19.01.2020.

²³⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, 15 qershor 2008, Neni 31.

10.4 Avokati i popullit dhe roli i tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Institucionin e Avokatit të Popullit sipas Kushtetutës së Kosovës është përcaktuar si kategori kushtetuese, përkatësisht si institucion i pavarur kushtetues. Roli i Avokatit të Popullit është të “mbikëqyr, promovon dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”²³⁷. Avokati i Popullit funksionin e tij e ushtron në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit i cili “ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese”²³⁸.

Njëkohësisht, Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë, i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. “Përbërja e Institucionit të Avokatit të Popullit sipas Ligjit për Avokatin e Popullit përbëhet nga: Avokati i Popullit, pesë zëvendës të Avokatit të Popullit dhe personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit”²³⁹.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë: “për ndërmarrjen e nismës legislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, me të cilin do të përcaktoheshin mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore, në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut”²⁴⁰. “Prandaj, ai ka për detyrë që ex officio (sipas detyrës zyrtare) apo në bazë të një ankese, të hetohet veprimi apo mosveprimi i autoriteteve publike të cilat mund të kenë shkelur të drejtat e ndokujt. Për më

²³⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit, 15 qershor 2008, Neni 132.

²³⁸ LIGJI Nr. 05/L -019 PËR AVOKATIN E POPULLIT, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 16/26 qershor 2015, PRISHTINË, Neni 1.

²³⁹ LIGJI Nr. 05/L -019 PËR AVOKATIN E POPULLIT, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/Nr. 16/26 qershor 2015, PRISHTINË, Neni 1 dhe Neni 5.

²⁴⁰ Institucioni i Avokatit të Popullit, RAPORTI VJETOR 2018, Nr. 18, Prishtinë, 2019, fq. 36.

tepër, funksionet e tij në lidhje me parandalimin e torturës u japin zyrtarëve të tij të drejtën që të kenë qasje në qendrat e paraburgimit dhe të kërkojnë çfarëdo dokumenti nga institucionet publike”²⁴¹. “Institucioni ka adresuar çështjen duke kërkuar në mënyrë aktive veprime të tilla, duke e ngritur çështjen në nivel qendror dhe duke i turpëruar njësitë dhe organet jobashkëpunuese. Kjo është një strategji e zakonshme që përdoret nga institucione të ngjashme përgjatë tërë Evropës, ku ka rezultuar me sukses të pabarabartë, kryesisht në varësi të kontaktit publik të Avokatit të Popullit përkatës”²⁴².

Shikuar në përgjithësi, Institucionin e Avokatit të Popullit ka qenë kredibil dhe në harmoni me dispozitat ligjore, edhe pse Avokatet e Popullit të cilët zgjedhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga Kuvendi i Kosovës, shumë herë kanë qenë subjekt diskutimi nga Mediet, Shoqëria Civile si dhe Analistët Politik. Por ky fakt nuk e zbehtë rolin që ka pasur dhe ka si Institucion Avokati i Popullit, e që në shumë raste ka qenë protagonist kryesor në përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

11. Realizimi i Hulumtimit: Perceptimi Qytetarë për Lirit dhe të Drejtat e Njeriut në Kosovë

Korniza ligjore e Kosovës është në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, por zbatimi i tyre në praktik mbetet akoma një sfidë për Institucionet e Kosovës. Autoritetet shtetërore duhet të sigurojnë buxhet të përshtatshëm për zbatimin dhe implementimin e ligjeve në praktik. Duhet të përmirësohen mekanizmat e të dhënave dhe monitorimit për të vlerësuar progresin në zbatimin e të drejtave themelore të njeriut. Qeveria e Kosovës ka marrë parasysh parimet kryesore: mos diskriminimi, pjesëmarrja e fëmijëve, zhvillimi i potencialit të plotë të fëmijës dhe interesat më të mira të fëmijës. Megjithatë, ende ka shumë për të bërë, në mënyrë që të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve të Kosovës dhe promovimi i progresit social.

²⁴¹Francisco Jose Garcia Martinez, Umberto Cucchi, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Një sistem i shfrytëzuar pak: Gjendja e Kornizës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Prishtinë, 2017, fq. 7.


²⁴² Po aty, fq. 7.

Hulumtimi në kuadër të Punimit të Magjistraturës është bërë me qytetarët e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në perceptimin e tyre se sa i njohin të drejtat dhe lirit themelore të njeriut në përgjithësi, e në veçanti deri ku dhe sa respektohen këto të drejta. Me qenë se ky është një Punim i Temës së Magjistraturës dhe fokus nuk e ka trajtimin e temës vetëm nga një këndvështrim, ky hulumtim lidhur me perceptimin e qytetarëve është bërë me një mostër mesatare prej 200 anketues, duke përfshirë pyetjet kyç që trajtohen në Punimin e Diplomës së Magjistraturës. Pyetjet për Hulumtim ashtu siç janë përcaktuar edhe në Projekt Propozimin e temës janë: A i njihni të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Konventat Ndërkombëtare dhe me Ligjet e Kosovës? Sa mendoni se respektohen të drejtat e njeriut në Kosovë? Cila kategori e njerëzve konsiderohet më e marginalizuar në Kosovë? Sa respektohen të drejtat e fëmijëve në Kosovë? A respektohen të drejtat e Grave në Kosovë të garantuara me Konventat Ndërkombëtare dhe me Ligjet e Kosovës?

11.1 Anketa


Analiza e Hulumtimit: Perceptimi Qytetarë për Lirit dhe të Drejtat e Njeriut në Kosovë

A. Gjinia
200 Responses




Hulumtimi është realizuar në periudhën kohore Shkurt, Mars dhe Prill të Vitit 2020, përmes Platformës Elektronike Google Forms. Hulumtimi kryesisht është realizuar në regjionin e Prishtinës, por me qenë se Hulumtimi ka qenë elektronik, nuk përjashtohen rastet se ka mundur të ketë anketues edhe nga regjionet apo Komunitat e tjera të Kosovës.

Në këtë hulumtim kanë marr pjesë 200 anketues, të cilët kanë qenë të lirë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetësin. Nga ta 53 % janë meshkuj, ndërsa 47 % janë femra. Duke pasur parasysh rendësin e hulumtimit përqindja e gjinisë nuk ka qenë determinues se sa duhet të jenë meshkuj dhe sa femra, ngase përmes pyetësorit kam synuar pikëpamjet reale të anketuesve lidhur me lirit dhe të drejtat e njeriut në Kosovë. Përqindja e përafërt e anketuesve meshkuj dhe femra është një mostër e mirë lidhur me pikëpamjet dhe përfundimet që dalin nga pyetësi.




Në pyetjen se sa qytetarët e Kosovës i njohin të drejtat themelore të njeriut të cilat janë të garantuara me Konventat Ndërkombëtare, të obligueshme dhe të aplikueshme me Kushtetutën dhe me Ligjet e Republikës së Kosovës, shohim se ka një pasqyrë të ndryshme nga pikëpamja e qytetarëve. Nga të dhënat shohim se ata të cilët i njohin të drejtat e njeriut janë 33 %, ndërsa

ata të cilët nuk i njohin fare këto të drejta janë 21 %, kurse 46 % janë deklaruar se i njohin pak të drejtat dhe lirit themelore të njeriut. Përqindja nga pyetësi mbase mund të jetë shqetësuese për faktin se 21 % nuk kanë as njohurit elementare mbi të drejtat elementare të njeriut, duke ia shtuar 46 % të atyre të cilët janë deklaruar se pak i njohin këto të drejta. Kjo përgjigj mbase duhet shikuar në disa aspekte dhe problemi duhet shikuar në shumë dimensione si ai i shkollimit, humbjes së besimit në institucionet, apo mund të konsiderohet si mosinteresim qytetarë për njohjen e të drejtave të tyre në aspektin ligjor më pas në atë shoqëror.




Ndërsa në pyetjen se sa respektohen të drejtat dhe lirit themelore të njeriut në Kosovë, nga diagrami i përqindjeve shohim se 25.5 % mendojnë se të drejtat e njeriut respektohen shumë mirë, 40 % mendojnë se të drejtat e njeriut respektohen mirë, 20 % mendojnë se të drejtat e njeriut respektohen pak, kurse 14.5 % janë deklaruar se të drejtat e njeriut nuk respektohen aspak. Shikuar nga praktika mbase deklarimet e qytetarëve mund të shihen si reale, por kthyer në përqindje shohim se respektimi i të drejtat të njeriut akoma është larg standardeve të vendeve demokratik edhe pse Kosova si në aspektin institucionale po ashtu në atë shoqëror

vazhdon të përballët me problem të shumta. Një pasqyrë e tillë mbase kërkon reflektim nga të gjitha Institucionet përgjegjëse dhe shoqëria në përgjithësi.




Në pyetjen se cila kategori e njerëzve konsiderohet më e marginalizuar në Kosovë, fëmijët konsiderohen të diskriminuar me 10 %, gratë konsiderohen të marginalizuara 32.5 %, njerëzit me nevoja të veçanta 28 %, komuniteti RAE (Rom, Egjiptian dhe Ashkali) 28 %, kurse të tjera por që nuk e kanë specifikuar se cila kategori është 1.5 %. Nga perceptimi qytetarë shohim se ndër kategoritë më të marginalizuara konsiderohen gratë duke u pasuar pothuajse me përqindje të njëjtë me dy kategoritë e tjera, njerëzit me nevoja të veçanta dhe Komuniteti RAE. Kjo përqindja mbase ka ndikuar edhe nga krijimi i opinionit publike nga rastet e dhunës në familje e sidomos humbjes së jetëve në disa raste si pasojë e dhunës në familje. Këtu duhet cekur se gratë akoma përballën me sfidën në realizimin e të drejtës pronësore dhe kjo sipas shumë studiueseve ka ndikuar në dhunën në familje. Ndërsa, tek njerëzit me nevoja të veçanta dhe komuniteti RAE kjo përqindje duket të jetë reale duke u bazuar edhe në shumë raporte vendore dhe

ndërkombëtare. Fëmijët sipas perceptimit qytetarë nuk konsiderohen ndër kategoritë që janë më të atakuarit edhe pse një pjesë e tyre jo çdo herë i realizojnë të drejtat e tyre të përcaktuar me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, Kushtetutën, Ligji për të Drejtat e Fëmijës si dhe me Ligjet e tjera që i mbrojnë të drejtat e fëmijëve.



Në pyetjen se sa respektohen të drejtat e fëmijëve në Kosovë, 0 % e të anketuarve mendojnë se të drejtat e fëmijëve nuk respektohen shumë mirë, 49 % mendojnë se respektohen mirë, 41 % mendojnë se respektohen pak, ndërsa 10 % mendojnë se të drejtat e fëmijëve nuk respektohen fare. Nga analiza e të dhënave duket shqetësuese fakti se asnjë nga të anketuarit nuk kanë menduar se të drejtat e fëmijëve respektohen në nivelin e duhur, madje duke bërë krahasimin me përqindjen e atyre që kanë menduar se nuk respektohen fare, kthyer në përqindje del të jetë gati e barabartë me dy alternativat e tjera. Kurse përqindja në mes dy alternativave të tjera, mirë dhe pak pothuajse është e përafërt edhe pse këtu dallimi nga të anketuarit si duket është parë më shumë në atë se të drejtat e fëmijëve jo çdo herë mund të respektohen mirë apo pak por mund të ndryshojnë në bazë të rrethanave dhe kushteve në të cilat ata/ato rriten.



Se a respektohen të drejtat e Grave në Kosovë, 17.5 % e të anketuarve mendojnë se po, 22.5 % mendojnë se jo, 44 % mendojnë se pak, ndërsa 16 % mendojnë se nuk respektohen fare. Për dallim nga pyetjet paraprake dhe kategoritë e tjera shohim se tek respektimi i të drejtave të grave përqindja e atyre të cilët mendojnë se respektohen është dukshëm më i madh por jo në nivelin e duhur, ndërsa të atyre që mendojnë se nuk respektohen është 22.5 %. Nëse e krahasojmë me pyetjen paraprake se cila kategori konsiderohet më e marginalizuar shihet se përputhet më shumë me përgjigjen se të drejtat e grave respektohen pak në shoqërinë kosovare. Kurse 16 % e të anketuarve të cilët janë përgjigjur se nuk respektohen fare, mund të jetë e barasvlershme me pyetjen paraprake që gratë konsiderohen si kategori më e marginalizuar në shoqërinë kosovare.

PËRFUNDIMI:

